

# DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» - Greikoc

Nr. 15 - Prill 2022 - Greikoc

*Urime 5 Prillin - Ditën e shkollës!*



UÇK

# NXËNËS TË DALLUAR TË SHKOLLËS SONË

## DUATE BËHEM MESUESE!



**Denisa Zenelaj** është një nxënëse me ambicie të veçantë. Vijon mësimin në klasën I/1 te mësuesi, Fikret Ramaj. Denisa është shembull për të gjithë me angazhimin e saj në të gjitha lëndët. Ajo pëlqen që në të ardhmen të bëhet një mësuese e suksesshme. Për këtë ka një shembull ideal mësuesin e saj, që me përkushtim të plotë praktikon këtë profesion. Andaj, një mësues ideal është ai që hyn në botën e fëmijëve dhe formon një njeri të aftë për shoqërinë. Urojmë që ëndrra t'i bëhet realitet!

## PROFESIONI I MJEKUT



**Bajram Canaj** nxënës i dalluar dhe me ambicie në klasën II/1 te mësuesi Tahir Zenelaj. Dëshiron që në të ardhmen të bëhet një mjek pasi që i pëlqen t'i ndihmojë të tjerët. Një mësues na ndihmon të përballemi me çdo lloj problemi në mësim, policia na ndihmon për çështjet sociale, po kështu një mjek na ndihmon të përballojmë çdo lloj parregullsie në trupin tonë. Vërtet ata janë heronjtë tanë, sepse mund të na bëjnë plotësisht në formë edhe më të mirë, prandaj dua këtë profesion!

## UNË DUA TË JEM GJYKATËS!



**Uron Tafaj** i vijon mësimet në klasën III/1 te mësuesja Elhamë Zenelaj. Dallohet për nga zgjuarsia e tij. Ëndrra e tij është që një ditë të bëhet gjykatës. Çdo ditë është një sfidë dhe diçka për të dashur nëse je gjykatës. Për më tepër çdo ditë është një nder, sepse ti e kupton përgjegjësinë tënde ndaj shoqërisë dhe mbi të gjitha ndaj palëve. Duhet të jesh i sinqertë dhe i drejtë në çdo gjë që ka të bëjë me të. Pra, gjyqtari në ëndërr përfaqëson diçka ose ndonjë situatë që duhet ta trajtoni me kujdes. Urojmë që ëndrra t'i bëhet realitet!

## ËNDRRA APO PASIONI!



**Lorina Ramadani** nxënëse shembullore në klasën III/2 te mësuesja Raza Spahiu. Lorina është një nxënëse me shumë ambicie e pasione. Në të ardhmen synon që të bëhet një mësuese e shkëlqyer, ku pasion ka kujdesin ndaj kafshëve (veterinarinë). Një mësuese mund të jetë një zog i lirë sa i përket shprehjes së ideve. Ajo mund të quhet mentor i shoqërisë. Shpresoj që ëndrra ime të realizohet dhe një ditë e do të bëhem një mësuese shembullore. Pasi që i dua shumë kafshët, gjithashtu, kam një pasion për to, ku dëshiroj që të kujdesem për to.

## DUA TA NDJEK PROFESIONIN E MËSUESES SIME!



**Erdona Lushaj** nxënëse e dalluar në klasën IV/2 te mësuesja Sevdie Lushaj. Erdona, si nxënëse me virtyte të shkëlqyeshme synon që në të ardhmen ta bëjë realitet ëndrrën e saj. Çdo fëmijë ka një ëndërr, të cilën dëshiron ta realizojë me punën e tij të palodhur, sinqeritetin, përqendrimin dhe vendosmërinë, ashtu siç e kam unë. Ëndrra ime është të bëhem një mësuese e mirë e dobishme dhe punëtore.

## MJEKËSIA - PROFESION HUMAN



**Elina Kurtishaj** është njëra ndër nxënëset më të suksesshme të klasës I/2 te mësuesi Sami Baraliu. Me përkushtimin dhe angazhimin që ka ndaj mësimin të të bëhet shembull për të tjerët. Ajo mendon se njerëzit kanë nevojë për ndihmë dhe shërim dhe duke iu ofruar këtë, beson se në të ardhmen do të bëhet një mjekje e përkryer. Suksese në profesionin tënd, Elina!

## MJEKËSIA - PROFESION QË MË PËLQEN



**Mear Qelaj** është nxënës në klasën II/2 te mësuesja Blerina Beqiraj. - Për Mearin mund të themi se është nxënës modest, i shoqërueshëm dhe mbi të gjitha edhe shumë i zgjuar. I pëlqejnë të gjitha lëndët, por më tepër matematika. - thekson mësuesja Blerinë. Meari mendon se do t'i ndihmojë të gjithë, pavarësisht nga statusi i tyre shoqëror apo etnik. Andaj, ai ka synim që në të ardhmen të bëhet një mjek i shkëlqyeshëm. Suksese në realizimin e ëndrrës, Mear!

## PROFESIONALISHT ËNDRRA IME ËSHTË TË BËHEM MËSUESE

**Jonila Zmajlaj** është nxënëse e klasës së III/2 te mësuesja Raza Spahiu. -Sigurisht se është një vajzë e zonja dhe inteligjente,- tha mësuesja Razë, andaj si çdo njëri prej nesh që kemi ëndrra, edhe Jonila ëndërron që në të ardhmen të bëhet një mësuese.



Profesionalisht ëndrra ime është të bëhem mësuese, pasi mendoj se është një punë shumë fisnike. Është profesion që ndryshon shoqërinë dhe ndihmon qeniet njerëzore në një orientim të mirë. Qëllimi im është që të jem mësuesja më e mirë, që çdo nxënës ka pasur dhe do të ketë gjatë gjithë shkollimit të

## NJË MËSUESE E PËRKUSHTUAR!



**Elita Kicaj** nxënëse e dalluar për sjelljet dhe suksesin e saj shembullor. Është në klasën IV/1 te mësuesja Besa Salihu. -Unë do të bëhem një mësuese e përkushtuar, pasi mësimdhënia është një nga punët më të rëndësishme në botë dhe, gjithashtu, një nga punët më shpërblyese. Më pëlqen ky profesion, pasi pa mësues nuk do të kishim qytetarë të arsimit, nuk do të mësonin matematikë, shkencë dhe nuk do ta kuptonim historinë e botës dhe se si funksionon ajo, - thotë Elita.

## SYNOJ TË BËHEM MJEK!



**Mushak Lushaj** nxënës ambicioz dhe me përkushtim ndaj dijes. Është në klasën V/1 te mësuesja Qëndresa Qelaj. -Dua të bëhem mjek! - thotë Mushaku. Të jem i tillë nuk është vetëm ëndrra ime, por edhe e disa bashkëmohatarëve të mi. Unë dua të jem ai që do t'i shërbej popullit dhe vendit tim. Dua të jem besnik ndaj pacientëve dhe detyrës sime, - thotë krejt në fund ky nxënës i zellshëm.

## NJË AKTOR SI DIONI!



**Dion Tafaj** nxënës me virtyte sjellje dhe angazhim të përkushtuar. Është në klasën V/2 te mësuesja Pranvera Selimi. Imagjinata është më e rëndësishme se dija, sepse dija është e kufizuar në gjithçka që ne tani dimë dhe kuptojmë. Ndërsa, imagjinata përfshin të gjithë botën dhe gjithçka që do të ketë ndonjëherë për të ditur dhe për të kuptuar. -Prandaj, unë imagjinatën time dua ta bëjë realitet, duke qenë aktor, - shprehet Dioni.

Përgatiti: Raza SPAHIU

## DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» - Greikoc

Nr. 15 - Prill 2022 - Greikoc

Urime 5 Prillin - Ditën e shkollës!



### DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e shkollës fillore dhe e mesme të ulët

“Dëshmorët e Greikocit”

#### PËR BOTUESIN:

Bestar BEQIRAJ, prof.

#### REDAKTOR PËRGJEGJËS:

Fikret RAMAJ

#### KOLEGJIUMI I REDAKSISË:

Tahir ZENELAJ

Merita KUKAJ

Besa BEQIRAJ - SALIHU

Raza SPAHIU

#### BASHKËPUNËTORËT:

Hashim KUKAJ

Sedat SELIMI, Zvicër

Nasuf KRASNIQI

Elhame ZENELAJ

Gani KICAJ

Haki BEQIRAJ

Ardhmërie BARALIU

Fahri KUKAJ

Eulona BEQIRAJ, nxënëse

Njomza TAF AJ, nxënëse

#### KORREKTORË:

Zelie LUSHAJ

#### SEKRETAR I REDAKSISË:

Samir BARALIU

#### BALLINËN E PUNOI:

Artan BEQIRAJ, dizajner grafik

Realizimi kompjuterik në redaksinë e revistës “FIDANI” - Prizren

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen.

## GJAKU I SHKRONJAVE

Vinte drejt atdheut,  
Voskopojës drejt,  
një karvan i vogël,  
një karvan i shpejtë.

-Arkat me florinj  
si nuk çahen malit,  
si nuk thyhet dot  
një samar i kalit?!

Pse s'i doli kush  
Karvanit në pritë,  
ta vrasë Dhaskal Thodrin,  
të rrëmbejë florinj të.

Pse s'i vloi murtaja,  
varret pse s'e zunë,  
uratë një grusht popull,  
një grusht, hiç më  
shumë!?

Hedhur sipër natës,  
sipër kohës hedhur,  
thikë e fanariotit  
në dy tehe derdhur.

Koha veshur dendur  
me rrobe tradhtie,  
po më rëndë kolera  
në ballë Arbërie.

Nën këmbë kuajsh  
rëndë gjëmonte toka,  
për fjalën e mëmës  
djalit i shkon koka.

Për një fjalë të shkruar  
digjej i tërë vendi,  
digjej tërë atdheu  
vritej tërë kuvendi.

Vinte drejt atdheut  
me të shkronja derdhur,  
për to çdo pëllëmbë  
Evropën kish shkelur.

Trokalet e gjakut  
Ballkani po rrihte,  
për erën e plumbit  
gjumi nuk e zinte.

Hedhur sipër kohës,  
natës së vonuar,  
thikë e fanariotit  
në tehe farkuar.

Derdhur nëpër plumb  
vdekja e Dhaskalit,  
dija edhe munda  
për djalin e djalit.

1990

Musa Bushrani, poet

### FALËNDERIM

*Drejtorja e shkollës, Këshilli Drejtues i Shkollës, stafi i mësimdhënësve, nxënësit, si dhe redaksia e revistës e falënderon nga zemra sponsorin gjeneral – Shoqatën “Greikoci”, që na ndihmoi për nxjerrjen e këtij numri.*

## BASHKËPUNIMI ME PRINDËR DO TË NA SHËRBEJË SI RRUGË LEHTËSUESE PËR PROCESIN EDUKATIV

*Drejtori i shkollës, Bestar Beqiraj ka mbaruar studimet universitare për gjuhë angleze në Universitetin e Prishtinës. Gjithashtu, ka përfunduar edhe studimet master për menaxhim dhe udhëheqje në arsim. Ai me kënaqësi pranoi që t'i përgjigjej pyetjeve tona.*



### D. E GREIKOCIT:

*I nderuari drejtor, për lexuesit e revistës sonë ju lutem na tregoni se kush është Bestar Beqiraj?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Quhem Bestar Beqiraj. Kam lindur në Greikoc, ku edhe kam përfunduar shkollën fillore. Pra, edukimin e fillova nga shkolla ku tani jam drejtor. Kur përfundova shkollën e mesme të mjekësisë, ardhja e ndërkombëtarëve në Kosovë rriti interesimin tim për studiuar gjuhë dhe letërsi angleze, në kuadër të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Kam punuar profesor në shkolla të ndryshme, por nga dëshira për të kontribuar në fushën e arsimit përfundova magjistraturën në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Komunikimit – Dega Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim.

### D. E GREIKOCIT:

*Para thujse një viti jeni zgjedhur në krye të shkollës sonë. Cilat janë objektivat tuaja gjatë këtij mandati?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Objektivat tona janë një shkollë gjithëpërfshirëse dhe motivuese në partneritet me prindërit, ku zhvillohen të gjitha potencialet e fëmijëve, duke integruar teknologjinë informative të kohës, me mësimdhënës kompetent dhe udhëheqje mbështetëse e llogaridhënëse në bashkëpunim të përhershëm.

### D. E GREIKOCIT:

*Gjatë kësaj kohe sa jeni në krye të këtij institucioni mësimor, jeni ballafaquar edhe me problemin e pandemisë COVID-19. Ka pasur arsimtarë të infektuar. Na tregoni si keni arritur të menaxhoni këtë situatë?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Gjatë pandemisë COVID-19 kemi pasur mësues të infektuar dhe më pak nxënës, por kemi punuar sipas skenarëve të paraparë.

### D. E GREIKOCIT:

*Sa jeni të kënaqur me punën e personelit arsimorë në shkollën tonë, si dhe me angazhimin e nxënësve tanë për të nxënë dije?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Kemi një staf profesionistësh në detyrë. Nxënësit janë shumë të edukuar. Nga kjo vërejmë se në Greikoc prindërit punojnë me fëmijët e tyre.

### D. E GREIKOCIT:

*Ju dikur keni qenë nxënës i kësaj shkolle, kurse sot punoni me ata, që dikur i pate arsimtarë tuaj. Çfarë ndjenje është kjo?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Të punosh me mësuesit e tu është një ndjenjë e papërshkrueshme, kthim në kohë dhe dëshirë për të kontribuar bashkë me ta, që të nxjerrim nxënës të dijes.

### D. E GREIKOCIT:

*A mendoni se bashkëpunimi në mes të prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve (trekëndëshi didaktik) është në nivelin e duhur?*

### BESTAR BEQIRAJ:

Trekëndëshi didaktik po funksionon dhe është në nivelin e duhur. Ne, si shkollë, po bëjmë përpjekje për të përcaktuar përgjegjësitë dhe të drejtat reciproke për të përmirësuar edhe më tutje raportet nxënës-shkollë-prindër. Ne po i hapim

dyert për prindërit dhe do t'i balancojmë këto marrëdhënie, duke i arritur synimet e përbash-këta. Kjo do të na shërbejë si rrugë lehtësuese për procesin edukativ.

**D. E GREIKOCIT:**

*Trajnimet e shumta, seminarët që kanë ndjekur mësuesit tanë a mendoni se janë një bazë e mjaftueshme për të nxjerrë gjenerata të shkëlqyeshme?*

**BESTAR BEQIRAJ:**

Mësuesit e shkollës sonë kanë trajnime dhe seminare, gjë që dëshmohet se të gjithë janë mësues bashkëkohorë. Natyrisht, se kjo është bazë e mjaftueshme për të nxjerrë gjenerata të mira, si në mësim, ashtu edhe në sjellje.

**D. E GREIKOCIT:**

*Një dukuri shumë shqetësuese, që kohëve të fundit ka marrë hov është edhe largimi i nxënësve nga shkolla, të cilët po u bashkohen familjeve të tyre dhe po shkojnë në botën e jashtme. Cili është mendimi juaj?*

**BESTAR BEQIRAJ:**

Një dukuri që po na shqetëson shumë është edhe largimi i nxënësve për në shtete të tjera, por mendoj se tani është një stabilitet i lehtë në këtë proces.

**D. E GREIKOCIT:**

*Shkolla jonë prej kohësh nxjerr edhe revistën e saj. Cili është mendimi juaj për punën që po bënë redaksia e revistës?*

**BESTAR BEQIRAJ:**

Revista e shkollës ka një vlerë të madhe në promovimin e nxënësve të mirë. Është fat që shkolla ka një redaksi profesionale. Mund të them që është për t'u krenuar me këto botime, që nga edicionet e para arkiva e shkollës po pasurohet me këto botime.

**D. E GREIKOCIT:**

*Jemi në prag të Ditës së shkollës dhe përvjetorit të dëshmorëve të fshatit tonë. Mesazhi juaj për këtë datë...*

**BESTAR BEQIRAJ:**

Meqenëse jemi afër Ditës së shkollës dhe përvjetorit të dëshmorëve, mesazhi im për këtë datë është: Lavdi dëshmorëve dhe të punohet më shumë për vendin tonë!

**D. E GREIKOCIT:**

*I nderuari i drejtor, ju faleminderit për këtë intervistë!*

**BESTAR BEQIRAJ:**

Faleminderit edhe Juve!

Intervistoi: **Fikret RAMAJ**

## **BASHKËBISEDIM**

**Bisedë me mësuesen  
Pranvera Selimi,  
mësuese e Programit fillor**

### **AUTORITETI DHE RESPEKTI PËR MËSUESIN NUK DUHET TË SHUHEN KURRË**



*Mësuesja Pranvera Selimi u lind në fshatin Semetisht. Ajo ka mbaruar Fakultetin e Edukimit – Programin fillor në Universitetin e Prishtinës – Qendra në Prizren. Ka një përvojë prej 17 vitesh në arsim. Me kënaqësi pranoi t'i përgjigjej pyetjeve të Redaksisë.*

**D. E GREIKOCIT:**

*Kush është Pranvera Selimi ?*

**PRANVERA SELIMI:**

Quhem Pranvera Selimi. Kam lindur më 23.8.1980 në fshatin Semetisht të Suharekës. Shkollimin fillor e kam mbaruar në fshatin e lindjes, ndërsa shkollën e mesme e kam mbaruar në gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë. Pastaj kam regjistruar Fakultetin e Edukimit në Prizren drejtimi – Programi fillor.

Që nga viti 2005 kam filluar të punoj si mësuese e programit fillor, fillimisht, në Reçan dhe Leshan pastaj nga viti 2007 deri më 2015 në Sh.f.m.u. “Gj. K. Skënderbeu”- Sallagrazhdë. Prej vitit 2015 deri më sot punoj në shkollën fillore të mesme të ulët “Dëshmorët e Greikocit” në Greikoc.

**D. E GREIKOCIT:**

*Çfarë mund të na thoni për punën tuaj në arsim?*

**PRANVERA SELIMI:**

Punën në arsim e kam admiruar gjithmonë. Prandaj, punën me fëmijë e bëj me një përkushtim të madh dhe me tërë qenien time mundohem që tek

ata të transmetoj dije, edukatë, respekt dhe sjelle të mirë, si dhe të aftësohen që t'i përballojnë të gjitha sfidat në jetën e tyre.

**D. E GREIKOCIT:**

***Çka mendoni, nxënësit në përgjithësi a janë në nivelin e duhur, si për nga mësimi, ashtu edhe nga sjellja?***

**PRANVERA SELIMI:**

Sipas mendimit tim nxënësit janë në nivelin më të lartë, për sa i përket dijës, pasi teknologjia ditëve të sotme ka arritur kulmin, ku fëmijët mund të marrin informata, sidomos, nga interneti, jo vetëm nga librat apo nga tekstet mësimore shkollore. Ndërsa, sa i përket sjelljeve mund të them që janë në nivelin e duhur, sepse sjellja varet edhe nga shumë faktorë, si: familja, shoqëria dhe rrethi i tyre, ku jetojnë dhe ajo manifestohet te fëmijët.

**D. E GREIKOCIT:**

***Gjatë kohës sa punoni në arsim, a mund të na veçoni ndonjë moment që ju ka ngjitur në kujtesë?***

**PRANVERA SELIMI:**

Ka shumë momente me nxënës pasi punoj që 15 vite, por do të veçoja gjeneratën time të parë, ku ende i mbaj të freskëta kujtimet dhe falënderimet që më kanë dhënë për punën, kujdesin dhe dashurinë, që jam munduar ta reflektoj tek ata.

**D. E GREIKOCIT:**

***A mendoni se mësuesi i sotëm e ka autoritetin që e pati mësuesi i dikurshëm?***

**PRANVERA SELIMI:**

Pasi kohërat kanë ndryshuar mjaft shumë mendoj që autoriteti i mësuesit nuk është si më parë, por duhet ditur se respekti dhe autoriteti për mësuesin nuk duhet të shuhet kurrë.

**D. E GREIKOCIT:**

***Zbatimi i kurrikulës së re në procesin mësimor ka filluar para disa kohësh te ne. Sa po gjen zbatim dhe a ka vështirësi në implementim?***

**PRANVERA SELIMI:**

Fillimisht kemi pasur vështirësi në zbatimin e kurrikulës së re, e cila ka për qëllim një qasje të re metodologjike të mësimdhënies dhe

nxënies, ngase ka pasur probleme me tekstet mësimore dhe informacione të pakta për zbatimin e saj. Por, tani me disa trajnime të organizuara nga MASHT-ti i kemi tejkaluar këto vështirësi dhe sot kurrikula e re implementohet, pothuajse, në tërësi.

**D. E GREIKOCIT:**

***Një dukuri shqetësuese e kohëve të fundit është edhe largimi i nxënësve nga shkolla. Cili është mendimi juaj për këtë dukuri?***

**PRANVERA SELIMI:**

Viteve të fundit kjo dukuri mjaft shqetësuese është paraqitur në tërë vendin, pasi nxënësit po emigrojnë në perëndim, duke shpresuar për një jetë më të mirë. Si pasojë e gjithë kësaj po zvogëlohet numri i nxënësve dhe mësimdhënësit rrezikojnë të humbin vendet e punës.

**D. E GREIKOCIT:**

***Dy- tri fjalë për revistën e shkollës sonë?***

**PRANVERA SELIMI:**

Ju përgëzoj për punën e palodhshme që po bëni për vite me radhë, duke u dhënë hapësirë nxënësve që të shpalosin talentin e tyre në shumë fusha, si dhe dhënien e shumë informacioneve për komunitetin për punën e mirë, që po bëhet në shkollën tonë.

**D. E GREIKOCIT:**

***Jemi në prag të 5 Prillit –Ditës së shkollës sonë. Cili është mesazhi juaj?***

**PRANVERA SELIMI:**

Uroj për të gjithë mësimdhënësit shëndet dhe shumë suksese në punën e tyre të shenjtë, nxënësve, po ashtu, suksese në rrugëtimin e tyre drejt dijës, si dhe bashkëpunim më të madh mësues –prind dhe nxënës në mënyrë që suksesi të jetë më i mirë.

**D. E GREIKOCIT:**

***Faleminderit për bisedë!***

**PRANVERA SELIMI:**

Me nder qofshi!

***Biseduan: Besa Salihu & Elona Beqiraj***  
***Dëshmorët e Greikocit***

## PROJEKTE KONKRETE GJATË PRANVERËS SË VITIT 2022

### Hyrje

Viti 2021 filloi me ankthin rreth pandemisë Covid-19, ku ndikoi dukshëm në aktivitetet e Shoqatës "Greikoci". Në gjysmëvjetorin e parë, pothuajse Shoqata nuk kishte fare takime të drejtpërdrejta. Njëkohësisht, Shoqata "Greikoci" "humbi përballë coronavirusit edhe dy anëtarët e saj: Haxhi Beqiraj 65-vjeç dhe Halil Kicaj 45-vjeç. Për këtë kryesia e Shoqatës "Greikoci" ndjeu dhembje dhe shpreh ngushëllimet më sinqerta për familjet e tyre, si dhe falënderimet për kontributin që dhanë të ndjerët për shoqërinë tonë. Fokusi i Shoqatës "Greikoci" për vitin 2021 ishte realizimi i punës së parkut të ri "Te Gryka", i cili në bashkëpunim me kryesinë e fshatit Greikoc u emërua në gusht të këtij viti. Realizimi i këtij parku ishte prioritet për shoqatën tonë, pasi kjo hapësirë e rivalizuar dhe e rregulluar shërbeu për vite për

nxënësit e shkollës fillore të fshatit Greikoc si vend për shëtitje. Prej pasluftës e deri në fillim të këtij viti ishte transformuar në një vend deponie për mbeturina të ngurta dhe nuk ishte hapësirë, ku banorët e Greikocit mund ta shfrytëzonin për shëtitje. Në mënyrë që kjo hapësirë t'u shërbejë banorëve të Greikocit për ndërmarrjen e aktiviteteve sportive dhe rekreative, Shoqata "Greikoci" vendosi që realizimi i këtij projekti të jetë prioritet për vitin 2021.

Me shpresën se viti 2022 do të jetë më i mirë dhe më me pak kufizime organizative për shoqërinë tonë, ne synojmë që më 1 gusht 2022 të organizojmë një takim festiv në Greikoc, ku do të shërbejë si pikëtakim për vendësit dhe mërgatën vendase. Rreth organizimit të këtij eventi do të njoftoheni me kohë. Kështu që për vitin 2022 Ju urojmë shëndet dhe të gjithë të mirat!

### Parku "Te Gryka" (maj - dhjetor 2021)

Gjatë muajit maj të vitit 2021, Shoqata "Greikoci" vendosi që në bashkëpunim me komunën e Suharekës, të pastrojë hapësirë mbi Xhaminë e fshatit dhe pranë lagjes Kicaj, e cila ishte e stërmbushur nga mbeturinat e ngurta. Komuna e Suharekës iu përgjigj pozitivisht kërkesës së Shoqatës dhe participoi në realizimin e parkut "Te Gryka" me mbulimin e kostove për rrafshimin e terrenit, ku dhuroi 10000 euro për realizimin e këtij parku. Parku në fjalë, i cili për të parën herë është prezantuar në tetor të vitit 2020 dhe, kryesisht, është e përfunduar. Duhet theksuar se është projekti më i madh i realizuar ndonjëherë nga Shoqata "Greikoci". Parku "Te Gryka" përfshinë: shtigje për ecje apo vrapim diku deri në 2 km, 2 kënde me lodra për fëmijë, 3 hapësira për skarë, hapësira e pushimore të gjelbëruara dhe gjolin e rivalizuar, i cili ka qenë projekt më vete, po në këtë vit. Inaugurimi i parkut në fjalë do të bëhet në pranverë të vitit 2022.



### Pako ushqimore për 9 familje (maj 2021)

Situata me COVID-19, që po sundon në gjithë botën, por edhe në muajin e shenjtë të Ramazanit, shtyu Shoqatën "Greikoci" që të shpërndajë pako ushqimore për 9 familje të nevojshme të Greikocit.



### Kënga për dëshmorët e Greikocit (qershor 2021)

Shoqata „Greikoci" i doli në mbështetje Ramadan Krasniqit për realizimin e një vidioklipi të ri të këngës, e cila iu dedikua dëshmorëve të fshatit Greikoc.



## Realizimi i "Gjolit" në parkun "Te Gryka" (dhjetor 2021)

Për realizimin e pellgut të njohur "Gjoli" brenda zonës së parkut "Te Gryka" Shoqata „Greikoci” kishte ndarë 1000 euro. Me nismën e anëtarit të kryesisë, Nezir Selimaj për ta realizuar këtë projekt në mënyrë vetjake, Shoqata "Greikoci" vendos që ta mbështesë pjesërisht Nezirin në realizimin e këtij projekti, pasi Shoqata nuk kishte fonde të mjaftu-eshme për realizimin e pellgut me dimensionet e më-dha, siç është re-alizuar nga Nezir Selimaj.



## Mirëmbajtja e fshatit Greikoc (janar - dhjetor 2021)

Ju rikujtojmë se për mirëmbajtjen e fshatit Greikoc aktualisht janë të angazhuar: Rexhep Lushaj dhe Haxhi Haxhaj, ku falë punës së tyre, fshati Greikoc gëzon një nivel më të lartë të pastërtisë, se sa vendbanimet e tjera të komunës së Suharekës. Rexhepi dhe Haxhiu, gjithashtu, janë përgjegjës për hapjen e varrezave në Greikoc. Në këtë vit, Shoqata bëri blerjen e disa aparateve për ta siguruar mirëmbajtjen.



## Falënderim për anëtarët (dhjetor 2021)

Në shenjë falënderimi, Shoqata "Greikoci" vendos që t'ua shpërndajë të gjithë anëtarëve, kontribuuesve dhe sponsorëve nga një kalendar për vitin



Nr. 15 - prill, 2022

2022. Kalendarin në fjalë ka flamurin e Shoqatës. peizazhe të tjera të fshatit Greikoc, si dhe foto të objekteve të tjera shoqërore të fshatit, si: shkollën, xhaminë, ambulancën dhe lapidarin.

Kalendarët mund të merren në Kosovë te Ramadan Canaj, kurse në Zvicër te Rexhep Neziraj.

### Rreth shoqatës „Greikoci”:

Themelimi: 17 maj 2015  
Selia: Ossingen ZH - Zvicër  
Numri i anëtarëve: mbi 220  
Kryetar: Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)  
Webfaqja: www.greikoci.ch  
Kontakt: shoqata\_greikoci@gmx.ch  
Facebook: Shoqata Greikoci

## Synimet për vitin 2022

Për vitin 2022, kryesia e Shoqatës ka vendosur që të vazhdoi fokusin kryesor për mirëmbajtjen e ambientit të fshatit Greikoc dhe krijimin të një zone rekreative, ku banorët e Greikocit do të kenë hapësirë për të ndërmarrë aktivitete sportive. Gjithashtu, do të përkrahë në vazhdimësi projekte, ku mbështetjen të rinjtë e fshatit Greikoc. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2022.

*Sedat SELIMI*

### LEONI

*(Kushtuar nxënësit tonë, Leon Kurtishaj,  
i cili humbi jetën tragjikisht)*

Mësues i dashur si ndihesh pa mua  
Klasës tënde çdo herë kam për t'i munguar  
Mësues i dashur pse po heshtë  
Unë e di sa fort më ke deshtë.

Unë e di sa më ke vlerësuar  
Andaj ty s'mundem me të harrur.  
Të bukura buqetat me lule  
Mbi bankë m'i ke ofruar  
Por ato nuk kanë aromë pa mua.

Kur pranë bankës ke për t'u ofruar  
Mendja tek unë ka për të të shkuar  
Unë e di se e ke problem  
Kur ditarin e hap në faqen tem.


Ke me hesht duke menduar  
Kush të përgjigjet ty për mua.

*Mr. sc. Besim Halitaj*

Dëshmorët e Greikocit



## MËRGIMTARI I DEVOTSHËM, BAFTI LUSHAJ - SHEMBULL PËR TË MIRË



Mërgimtari i devotshëm, Bafti Lushaj çdo herë ka kontribuar dhe po kontribuon për shkollën e Greikocit, kur dikur ishte nxënës i saj. Këto ditë ai ishte në

vendlindje dhe menjëherë e vizitoi shkollën tonë, ku dhuroi veshje të mjaftueshme të sportit për gara të ndryshme sportive. Edhe pse mungon salla e edukatës fizike në shkollën tonë, kontributi i mërgimtarëve sa vjen e shtohet. Mërgimtarët tanë në përgjithësi, e në veçanti Bafti Lushaj po



kontribuojnë shumë, që fëmijët tanë të jenë të suksesshëm në çdo pore të jetës. Duhet potencuar se ndihma që solli Bafti Lushaj është

sa katër ekipe në futboll e volejball mund të



pajisen me veshje adekuate sportive. Na mban shpresa se shumë shpejt nga komuna e Suharekës të ndërtohet ndonjë sallë e edukatës fizike apo edhe ndonjë palestër sportive, e cila do të shërbente për kalitjen fizike të fëmijëve tanë. Këtij mërgimtari i është falënderues edhe arsimtarja e



edukatës fizike, Bukurie Asllanaj, si dhe i gjithë stafi mësimdhënës.

**Fikret RAMAJ**

## BISEDË ME SHKAS: Elona Beqiraj, kryetare e Këshillit të nxënësve

Në shkollën tonë para disa ditësh, përveç organeve të shumta që janë zgjedhur në shkollën tonë, u zgjodh edhe kryesia e Këshillit të nxënësve, ku kryetare u zgjodh, nxënësja e klasës së nëntë (IX/2), Elona Beqiraj.

Elona u lind më 29. 9. 2007 në Prizren. Është nxënëse shembullore e shkollës sonë. Ne shfrytëzuar rastin dhe bëmë një bisedë të shkurtër me të. Ajo ndër të tjera theksoi: “Kam suksesin e shkël-qyeshëm. Leximi më pëlqen tejmasë. Si çdo e re tjetër, edhe unë kam ëndrrat e mia dhe dëshiroj të arrij sa më lart”, - shprehet në fillim të bisedës, Elona. Më pas



Elona vazhdon: “Dëshiroj që studimet t'i vazhdoj jashtë vendit. Adaptohem lehtë për çdo gjë. Motivohem shumë nga arritjet e të tjerëve. Më pëlqen shumë mjekësia. Si lëndë mësimore e preferoj shumë matematikën. Por, edhe gjuhët e huaja më pëlqejnë, të paktën 2-3 syresh shumë më pëlqejnë”, - shprehet në fund të kësaj bisede të shkurtër, Elona Beqiraj.

Elonës i dëshirojam suksese në të ardhmen. Të bëhet shembullore, ashtu siç ishte deri më tash. I priftë e mbara!

**Fikret RAMAJ**

## PËRVJETORI I DËSHMORËVE TË FSHATIT TONË

### DËSHMORËT JANË NDERI DHE KRENARIA E POPULLIT TONË MARTIR



Jakup Kurtishaj



Hazir Selimaj



Avdyll Beqiraj



Haxhi Haxhaj



Sabit Lushaj

### QE TE RRITEJN LULET E BARDHA

1.Flini të qetë,  
Se në gjakun tuaj do të shumëzohën  
pranverat e pavdekshme  
e zogjtë do të ndërtojnë cerdhe  
plisave tuaj të tretur.

Ju dhatë gjërat më të shtrenjta  
për të ngritur tempuj prej gjaku,  
që dielli të mos rrënohet,  
që toka të mos digjet.

ju mbollët besimin e jetës  
në rrënjët e luleve  
dhe me eshtra shkruat  
biografinë e dritës....

2.Flini të qetë!  
kjo tokë ju lindi  
nga hiri i ëndrrave të lirisë.  
që të këtë rreze dita,  
që të këtë ujë burimi,  
që të rriten lulet e bardha  
në mendjen e njerëzimit,  
që nga shpirti të shpërthejë bardhësia  
që liri të këtë me bollëk,  
që të shtrohet buka pa frikë në sofër,  
që njeriu mbi tjetrin të mos ngrihet si bishë,  
që kopsht lulediejsh të bëhet jeta.

3.Flini!  
Ju ka hije gjumi i përrjetshëm,  
sepse s'dëshët të jetoni të vdekur në jetë,  
pa dashuri,  
pa gaz në fytyrë,  
pa shpresa në zemër,  
pa tokë, që mbani si shtrojë  
pa qiell, që mbani si mbulojë,  
pa lumenj, që ju burojnë në sy,  
pa diell, që mbani në duar...

4.Flini të qetë!  
Ju s'keni pse të ankoheni,  
gjërat më të shtrenjta  
i dhatë për Kosovën,  
dhe dashurinë tuaj e shenuat  
në cdo lule,  
në cdo gur,  
në cdo rrugë.



Zenel Curraj



Naser Tafaj



Safet Kicaj



Nuhi Tafaj



Fatmir Tafaj

**Din Mehmeti**

## **NË KËRKIM TË DITURISË, DUKE PLOTËSUAR MANGËSITË, SJELLJET DHE SHPREHITË TONA DO TË NDEROJMË VETVETEN, DËSHMORËT DHE KOMBIN TONË**

*Mësues Besimi u lind në Suharekë. Ka mbaruar magistraturën, ku mori titullin magjistër i shkencave të gjeografisë. Është duke punuar për studimet në PHD. Pa hezitim pranoi që t'i përgjigjet pyetjeve tona.*

### **D. E GREIKOCIT:**

***Mësues Besimi a mund të na tregoni në pika të shkurtra për biografinë tuaj?***

### **BESIM HALITAJ:**

Quhem Besim HALITAJ. Kam lindur dhe në Suharekë, ku dhe jetoj me familjen time. Jam i martuar dhe i kam 3 fëmijë: 2 djem dhe një vajzë. Kam përfunduar studimet SHLP në drejtimin Histori-Gjeografi, studimet bachelor në drejtimin Gjeografi - Ed. qytetare, gjithashtu, studimet master në gjeografi, ku mora titullin magjistër i shkencave të gjeografisë. Studimet nuk mendoj t'i ndal pasi që jam duke punuar për studimet në PHD. Tashmë kam 15 vite që punoj në shkollën e fshatit.

### **D. E GREIKOCIT:**

***Ju tashmë keni krijuar një përvojë në arsim. A mund të na thoni se cili është mendimi juaj për cilësinë në shkollat tona?***

### **BESIM HALITAJ:**

Sa i përket cilësisë, në arsim nuk mund të themi asnjëherë që kemi arritur pikën më kulmore, duke pasur parasysh se egoja për dije duhet të jetë e pafund. Arsytet për cilësinë e arsimit në shkollë nuk varen çdoherë nga vetë mësuesi, por ato janë një tërësi komponentësh e faktorësh të ndërlikura nga Ministria, DKA, drejtorja e shkollës e deri tek mësime të ndërlidhura.

Meqenëse në vendet e dala pas luftës vërehen vështirësi më të mëdha për shkak të infrastrukturës, modelit të mësimeve, etj., në vendin tonë janë ndërtuar plot shkolla të reja dhe është investuar në mjete të konkretizimit për një cilësi më të mirë. Por, kjo nuk po vërehet në shkollën tonë. Nuk janë bërë investime të mjaftueshme. Kemi mungesë laboratorësh në shkollë, mungesë



të mjeteve të konkretizimit, infrastruktura e brendshme jo e mirë. Të gjitha këto kanë ndikuar edhe në procesin e mësimeve dhe pritshmëritë në cilësi nuk mund të themi se janë të larta. Por, kur bëjmë një analizë nga sukseset që nxënësit kanë sjellë nga garat e mbajtura komunale, rezultatet e testeve, nga shkolla jonë ka plot nxënës të suksesshëm në fusha, si: IT, inxhinieri, mjekësi, etj. Mendoj se mësime të suksesshme e shkollës sonë kanë dhënë maksimumin, veçmas në vitin pandemik C-19, ku ishte sfida globale. Mendoj se cilësia është mjaft e mirë, krahasuar me shkollat e tjera.

### **D. E GREIKOCIT:**

***Çka mendoni për punën që bërë në të kaluarën (kur ju keni qenë nxënës) dhe me punën që po bëhet sot. Na e tërhiqni një paralele.***

### **BESIM HALITAJ:**

Krahasuar me punën që sot bëhet nga e kaluara, mësime të suksesshme janë më aktive, më komunikues, më tolerant. Por, si duket edukata, shprehjet dhe sjelljet janë më të papranueshme, që nxënësit bëjnë ndaj mësuesve. Ne nuk kemi pasur afërsi me

mësimdhënës, më pak mundësi komuni-kimi, por mendoj se sjellje dhe shprehi më të mira, gjithsesi kemi pasur.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Sa ka autoritet mësuesi i sotëm?***

#### **BESIM HALITAJ:**

Mund të thuhet se sot mësuesi është pa autoritet, pasi që politikat e qeverisjes demokratike në shkollë, u kanë dhënë shumë kompetenca fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Unë mendoj se si rezultat i lirive të tepruara sot ka edhe shumë parregullsi në sistemin arsimor, por asnjëherë nuk mendoj në shkeljen dhe liritë e të drejtave të fëmijëve.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Për këto vite që punoni në arsim a mund të na veçoni ndonjë detaj që ka lënë mbresa të pashlyeshme?***

#### **BESIM HALITAJ:**

Vitet e para kur kam filluar në arsim, për mua, gjeneratat e para kanë qenë të arta. Në çdo vit shkollor kemi nxënës të suksesshëm, por vitet e fundit më duket, sikurse, ka humbur rivaliteti i etjes për dije. Ato gjenerata më kanë lënë mbresa të paharruara. Kanë qenë shumë më punëtorë, më rivalë në duela për nxënie të dijës. Ata ishin të veçantë. Ata kanë përgatitur saitin apo web faqen e shkollës me plot dokumente, enciklopedi, të dhëna për nxënësit, mësuesit dhe fshatin, etj.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Sot punohet me kurrikulë të re. Sa po gjen zbatim kjo kurrikulë?***

#### **BESIM HALITAJ:**

Sa i përket kurrikulës në vendin tonë nuk gjen zbatim dhe duhet të kalojë kohë për pritshmëritë e kurrikulës, pasi që ajo është e ngarkuar më shumë në aspektin administrativ. Kushtet për zbatimin e saj mungojnë. Kemi mungesë tekstesh, harmonizim jo të mirë të tyre, mungesë të mjeteve konkretizuese, gjë që janë faktorët, që pamundësojnë zbatimin e mirë të saj. Pra: **“Një administratë finlandeze me kushte të zbatueshmërisë afrikane”**. Unë mendoj se me administratë jemi para Finlandës, që ka sistemin më të avancuar arsimor, kurse me kushte jemi me Afrikën.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***A mendoni se puna e mësuesit po***

***vlerësohet e po çmohet nga të tjerët?***

#### **BESIM HALITAJ:**

Kriminalizimi institucional, pranimi pa kriter i nxënësve, studentëve në shkolla e universitete, pastaj përzgjedhja e mësimdhënësve, drejtorëve në baza partiake e sipas cilësive, janë praktika jo të mira për sistemin arsimor në vendin tonë. Prandaj, sot kemi nënvlerësim dhe urrejtje. Kjo urrejtje është në dëm të mësimdhënësve, si rezultat i një numri të vogël të mësimdhënësve të pandërgjegjshëm rritet dëshira për fyerje dhe nënvlerësim. Por, nuk duhet harrur elitën e mësimdhënësve, që punuan pa paga për ta mbajur gjallë arsimin në vendin tonë.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Kjo bisedë zhvillohet për revistën e shkollës sonë. Çka mendoni për punën që po bënë redaksia e saj për botimin e kësaj reviste?***

#### **BESIM HALITAJ:**

Në radhë të parë në emrin tim, të mësimdhënësve dhe drejtorisë së shkollës e falënderoj Shoqatën e fshatit “Greikoci”, që mundësuan realizimin e botimit të numrit të radhës së revistës, njëherit për punën dhe mundin e mësues Fikretit për realizimin e këtij botimi.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Jemi në prag të 5 prillit – Ditës së shkollës sonë. Mesazhi juaj...***

#### **BESIM HALITAJ:**

Shkolla jonë mbanë emrin “Dëshmorët e Greikocit”, andaj unë po e mbyll bisedën me këto dy thënie:

“Në kërkim të diturisë, duke plotësuar mangësitë, sjelljet dhe shprehitë tona do të nderojmë vetveten, dëshmorët dhe kombin tonë”.

“Ne nuk vdesim nga nxënia e diturisë, nëpërmjet saj ne ngremë vlerën e dëshmorëve dhe familjeve të tyre”.

#### **D. E GREIKOCIT:**

***Faleminderit për bisedë!***

#### **BESIM HALITAJ:**

Me nder qofshi!

***Biseduan:***

***Besa BEQIRAJ&Sami BARALIU***

## ORGANET E SHKOLLËS SONË

**Këshilli Drejtues i Shkollës:** Tahir Zenelaj (mësimdhënës), Besim Halitaj (mësimdhënës), Fikret Ramaj (mësimdhënës), Ali Canaj (prind), Reshat Selimaj (prind), Isak Curraj (prind), Muhamet Kicaj (koordinatori i cilësisë) dhe Bestar Beqiraj (sekretar)

**Këshilli i mësimdhënësve:** Sami Baraliu (kryetar), Gani Kicaj, Haki Beqiraj, Elhame Zenelaj, Ferat Beqiraj dhe Raza Spahiu – anëtarë.

**Këshilli i prindërve:** Shaip Selimaj (kryetar), Adem Shahinaj, Naim Neziraj, Jetmir Kicaj, Shpresa Kurtishaj dhe Valbona Selmanaj – anëtarë.

**Këshilli i nxënësve:** Elona Beqiraj (kryetare), Fjolla Tafaj, Blendrit Beqiraj, Melisa Kurtishaj, Nazmie Selimaj dhe Ledion Kurtishaj – anëtarë.

**Këshilli pedagogjik-disiplinor:** Zelig Lushaj, Fikret Ramaj, Elhame Zenelaj, Nasuf Krasniqi, Haki Beqiraj dhe Sami Baraliu.

**Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (EPRBM):** Besim Halitaj (menaxheri), Bajram Neziraj, Besa Salihu, Qëndresa Gashi, Merita Kukaj dhe Qëndresa Qelaj.

**Ekipi për ruajtjen e ambientit dhe të mjedisit shkollor:** Gani Kicaj (koordinatori), Bukurie Asllanaj, Raza Spahiu, Sevdie Jemini dhe Blerina Beqiraj.

**Ekipi për promovim të shëndetit:** Saranda Kabashi (koordinatore), Bukurie Asllanaj, Pranvera Selimi, Qëndresa Thaçi, Sevdie Jemini dhe Ardhmërie Baraliu.

**Komisioni (Komiteti) për hapjen e**

**kutive të ankesave:** Zelig Lushaj, Hashim Kukaj, Merita Kukaj, Besa Salihu, Sevdie Jemini dhe Blerina Beqiraj.

**Ekipi për parandalimin e dhunës dhe bullizmit:** Qëndresa Gashi (koordinatore), Zelig Lushaj, Nasuf Krasniqi, Haki Beqiraj, Pranvera Selimi dhe Qëndresa Qelaj.

**Ekipi për promovimin e nxënësve talentë:** Fikret Ramaj (koordinatori), Gani Kicaj, Merita Kukaj, Fahri Kukaj, Ardhmërie Baraliu dhe Saranda Kabashi.

**Ekipi për vlerësimin e brendshëm të shkollës (VBSH):** Muhamet Kicaj (koordinatori), Fikret Ramaj, Sami Baraliu, Besim Halitaj, Hashim Kukaj dhe Raza Spahiu.

**Aktivitetet profesionale:**

- **Aktivi i shkollës fillore:** Fikret Ramaj, kryetar dhe arsimtarët e shkollës fillore.

- **Gjuhët dhe komunikimi:** Haki Beqiraj, Merita Kukaj, Nasuf Krasniqi, Zelig Lushaj, Muhamet Kicaj dhe Donika Emini.

- **Artet:** Fahri Kukaj dhe Ardhmërie Baraliu.

- **Matematika:** Ferat Beqiraj dhe Saranda Kabashi.

- **Shkencat natyrore:** Gani Kicaj, Shaban Beqiraj dhe Murat Berisha.

- **Shoqëria dhe mjedisi:** Bajram Neziraj dhe Besim Halitaj.

- **Edukata fizike, sportet dhe shëndeti:** Bukuria Asllanaj.

- **Jeta dhe puna:** Hashim Kukaj.

**Këshilli Drejtues i Shkollës**

## ANKETË ME NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA

### VENDIMMARRJA NË KARRIERË ËSHTË NDËR MOMENTET MË TË RËNDËSISHME NË JETËN E NJERIUT


*Nxënësit e klasave të nënta janë afër përfundimit të këtij viti shkollor. Redaksia e revistës sonë vendosi që të zhvillojë një anketë me ta. Ata pa hezitim pranuan që t'i përgjigjen pyetjes së Redaksisë: "Cila do të jetë preferenca juaj për të ardhmen?"*



**AURELA SELIMAJ:** Unë i jam shumë mirënjohëse familjes sime, të cilët më dhanë përkrahje në çdo aspekt. Gjithashtu, i jam shumë mirënjohëse edhe mësuesve tanë, të cilët nuk kursyen asgjë që vetëm e vetëm ne të jemi shembullor në çdo aspekt të jetës.

Pas klasës së nëntë mendoj të regjistrohem në shkollën e mesme të mjekësisë në drejtimin e stomatologjisë. Kam besim në vetvete. Ky profesion më pëlqen dhe ka shumë vlerë për mua. Prandaj, do t'i përkushtohem shumë që ta arrij këtë qëllim. Natyrisht, këtë do ta arrij me ndihmën e mësuesve tanë dhe me përkrahjen maksimale të prindërve të mi.

**OLTIONA TAFAJ:** Klasës së nëntë po i vjen fundi. Tashmë ka ardhur koha të mendojmë më qartë dhe më mirë për të ardhmen tonë. Moda dhe stili kanë qenë çdoherë pasioni im më i madh. Prandaj, në shkollën e mesme do të regjistrohem në degën e dizajnit.



**DENISA CANAJ:** Tani meqenëse jemi në klasën e nëntë, secili nga ne po mendon drejtimin që i pëlqen për të vazhduar më tutje. Edhe unë si çdo nxënës tjetër kam menduar atë që më pëlqen. Preferenca ime është të bëhem avokate. Më pëlqen shumë ky drejtim dhe uroj që ta realizoj këtë synim! Familjes i falënderohem shumë për përkrahjen e vazhdue-shme, si dhe stafit mësimdhënës të shkollës i jem shumë mirënjohëse për atë që bënë për ne.

**ERA CANAJ:** Udhëtimi më i gjatë është jeta. Një lojë sfiduese në mes të viteve dhe kohës. Mendoj që pas përfundimit të klasës së nëntë, kohën time do t'ia dedikoj mjekësisë. Kam vendosur që viteve në vazhdim t'i përkushtohem shkollimit. Kam shumë dëshirë që t'u ndihmoj njerëzve, prandaj edhe kam vendosur të zgjedh mjekësinë. Mjekësia ka qenë ëndërr imja dhe pikërisht tani ka ardhur koha që këtë dëshirë ta bej realitet. Është një rrugë e gjatë dhe e vështirë, por falë vullnetit dhe dëshirës arrihet gjithçka.



**LEA BEQIRAJ:**

Vendimmarrja në karrierë është ndër momentet më të rëndësishme në jetën e njeriut. Duhet të mendojmë mirë para se të merret ky vendim.

Edhe unë si çdo njeri tjetër kam një ëndërr, e cila më inspiron dhe më shtynë që të punoj edhe më shumë për ta realizuar. Mbi të gjitha prapa çdo ëndërr ekziston një motiv, që e forçon edhe më shumë mendimin për realizim. Ëndërra ime është të filloj në mjekësi – drejtimi i infermierisë. Me këtë rast dëshiroj të bëhem personi i parë në familje, i cili i ndihmon dhe i bënë ata të ndihen më të sigurt në këtë vend, ku shëndeti dhe mirëqenia e secilit prej nesh nuk është në nivelin që duhet të jetë. Një proverb mjekësor thotë: Parandalimi i sëmundjes është më i mirë se terapia! Andaj, studimi im në fushën e mjekësisë do të ndikonte pozitivisht te familja ime, fillimisht, e pastaj edhe te komuniteti, të cilit do t'i shërbej. Nuk kemi kohë për të humbur. E ardhmja është në duart tona, andaj duhet mirë të mendojmë si të vazhdojmë tutje.

## 7 MARS

Një ndër festat më të rëndësishme të muajit mars, pa dyshim është 7 Marsi – Dita e Mësuesit. Në këtë ditë u hap Shkolla e Parë Shqipe në Korçë, më 1887 nga mësuesi Pandeli Sotiri. 7 Marsi është lulja e parë e pranverës së vitit 1887. Mësuesi çdo ditë e më tepër po i jep jetë e dritë kësaj feste madhështore. Mësuesi ka tiparet e një prindi madhështor. Ai na mësoi shkronjat dhe numrat. Mësuesi është ai që çdoherë dhe në çdo kohë na përkrah dhe na motivon sa më shumë. Shpërblimi ynë më i madh për mësuesit tanë është që ne të mësojmë e të jemi sa më sjellshëm. Respekt të pafund për mësuesit tanë!

Lediona CANAJ, kl. VI/1

## EPOPEJA E UÇK-së

Pesë, gjashtë dhe shtatë marsi janë tre ditët më të lavdishme të historisë më të re të popullit shqiptar. Janë tre ditët, ku u vendos fati i shqiptarëve. Pra, në këto ditë marsi u sulmua kulla e komandantit legjendar, Adem Jashari. Aty, i madh e i vogël rrokën armët për të mbrojtur nderin e familjes, të kullës, por edhe të mbarë popullit shqiptar. Sakrifica e familjes Jashari vuri themelet e shtetit të Kosovës. Ky i lloj i rezistencës asnjëherë nuk kishte ndodhur në histori të njerëzimit. Adem Jashari dhe familja e tij ishin të palëkundur në qëndrimet e tyre. Kjo sakrificë bëri që shumë djem e vajza të mira të kombit t'i bashkohen Ushtrisë së lavdishme, për ta shporrur njëherë e përgjithmonë armikun barabar serb.

Zoti e mëshiroftë familjen Jashari dhe dëshmorët e kombit! Zoti e bekoftë kombin shqiptar!

Arnita KICAJ, kl. VIII/2

## NËNA IME

Fjala më e bukur në botë është fjala NËNË. Nëna ime më ka mbështetur gjithmonë dhe në çdo kohë, prandaj i jem shumë mirënjohëse. Nënë, ti çdo herë më ke dhënë forcë e kurajë për t'i përballuar situatat edhe atëherë kur unë nuk jam ndier mirë. Duart tuaja të arta gjithmonë ka qenë afër meje, duke më përkëdhelur e duke më dhënë dashuri prindërore. Unë nënën time do ta respektoj dhe do t'ia fjalën se do të jem më e mira, ashtu siç kanë dëshirë prindërit për fëmijët e tyre.

Nënë jam krenare që të kam! Të uroj më të mirat e kësaj bote! Jetofsh 100 vjet nëna ime e dashur!

Eliza LUSHAJ, kl. VII/1

**ALBESA KICAJ:** Jemi afër përfundimit të klasës së nëntë. Tani duhet të vendosim për jetën që duam të bëjmë.



Duke qenë se jam shumë e apasionuar pas modës, mendoj që në shkollën e mesme të vazhdoj në shkollën e mesme teknike “Skënder Luarasi” në drejtimin e dizajnit. Kjo është ëndërr imja e kamotshme. Tanimë ka ardhur koha që këtë ëndërr ta bëj realitet!

**FLORIDA LUSHAJ:**



Jemi në prag të përfundimit të klasës së nëntë. Përjetuam mo-mente të paharruara.

Falënderoj fami-ljen time dhe mësuesit që ishin të gatshëm çdoherë për ne. Secili nga ne ka një ëndërr. Edhe unë do të ndjek ëndërrën time. Dëshiroj të bëhem infermiere e suksesshme e të punoj me plot përkushtim. Shpresoj se kjo ëndërr imja të bëhet realitet!

**DRIOLA SELIMAJ:** Zgjedhja e profesionit të ardhshëm është një nga vendimet më të rëndësishme në jetë.



Gjithmonë kam ëndërruar të shkoj në shko-llën e mesme të mjekësisë, pra të bëhem mjekë. Sot, pothuajse kam vendosur përfundimisht që drejtimi i mjekësisë të jetë e ardhmja ime. Jam e përkushtuar që t'u ndihmoj njerëzve. Prandaj, me këtë rast dua ta falënderoj familjen time për përkrahjen e vazhdueshme, si dhe arsimtarët tanë për përkushtimin që patë ndaj nesh.

I anketuan:  
Raza SPAHIU & Elhame ZENELAJ

# P Ë R K U J T I M

## LEONI ISHTE DHE MBETI SHEMBULLOR

Vdekja e hershme e nxënësit tonë – nxënësit shembullor, **Leon (Arben) Kurtishaj** na pikëlloi të gjithëve. Vdekja e Leonit është një moment pikëllimi e dhembjeje. Ishte nxënës shembullor, i matur, i urtë, i palodhshëm dhe plot optimizëm.

Leon Kurtishaj ishte nxënës i shkollës së fshatit Greikoc. Ishte në klasën e tetë – në klasën e mësuesit Hashim Kukaj. Për Leonin të gjithë flisnin me admirim, ngase sjelljet që kishte e dëshmonin këtë.

E nderuara familje Kurtishaj, në këto momente të vështira për Ju, së bashku me Ju e ndajmë dhembjen që keni për Leonin. Leonin sa e donit Ju, e donim edhe ne, sepse ishte i tillë dhe ashtu do të mbetet përherë: i çiltër, i qetë, i buzëqeshur.

Kjo humbje e madhe nuk mund të shprehet dot me fjalë, por gjithmonë mund të konsideroni në mbështetjen tonë. Së bashku me JU, jemi të pikëlluar. Leoni sapo e përfundoi periudhën e parë të notave. Por, vdekja e hershme na e mori, po vetëm fizikisht, ngase prore do të jetojë në zemrat e të gjithëve.

Na mblodhi sot këtu kumti i dhembjes dhe i pikëllimit, me rastin e ndarjes nga biri, nxënësi



ynë i çmuar dhe shumë i dashur, Leon Kurtishaj, i cili deri me ditën e djeshme pati kufirin e jetës, duke na shkaktuar dhembje të thellë në mendjen dhe në zemrat tona.

Leoni ynë i dashur, vdekja e pabesë të kishte zënë priten, duke na lënë përjetë të varfëruar, sepse tash e tutje do të na mungojnë fjalët e tua të ëmbla dhe me plot peshë: buzëqeshjet e tua, ngrohtësia e jote shpirtërore. Do të na e falësh çastin e dobësisë sonë shpirtërore në këtë moment të ndarjes së përjetshme, duke e ndjerë si borxh për të gjitha ato fjalë të mira që na i le.

Paqja e përcolli në botën e amshuar. Butësia e tij i bënte për vete të gjitha zemrat e mira. Shpirti i tij që kërkonte më shumë dritë u mëshiroftë në qenien tonë. Shëmbëlltyra e tij që po lë pas e bëjnë Leonin që të jetojë përgjithmonë në shpirtin dhe në zemrat tona.

Prandaj, ne do ta kujtojmë, duke i ruajtur gjithmonë kujtimet më të mira për të. Do të kujtohet me pietet e krenari!

LAVDI I QOFTË JETËS SË TIJ!

U PREHTË NË PAQE KY ENGJËLL!

**Hashim KUKAJ**

## LEON, NA E BËRE TË RËNDË FILLIMIN E PERIUDHËS SË DYTË MËSIMORE!

(10 janar 2022)

Sot po fillojmë mësimin pas pushimit dimëror. Festat e fundvitit kaluan. Dimër nuk mund të themi se kishte, sepse ne, po s'e pamë borën nuk e quajmë dimër. Koha ishte e mirë këto ditë, por ngjarja që ndodhi më 2 janar 2022 na tronditi. Na ftohu zemrat. E zbehu çdo moment hareje që kishim pasur për festa. Zemra na u bë e ftohtë akull. Gjaku u ngri, e lotët rridhnin pa mundur t'i kontrollojmë ato.

Një cingërimë telefoni bëri që çdo gjë ta kthente në moment pikëllimi, përhumbjeje, mosbesimi për ato që po dëgjoja. Thosha më vete që nuk është e mundur. Nuk doja të besoja. Doja të ishte një ëndërr, t'i hapja sytë e të gëzohesha që s'ishte e vërtetë. Por jo, kjo ishte e vërtetë: tre nxënës tanë kishin pësuar aksident. Njëri nga ta u largua nga ne, u bë engjëll e fluturoi lart në qiell, duke mosmenduar për ata që la pas: familjen,

shoqërinë, shkollën, fushën e futbollit e shumë ëndrra të sapofilluara e tani të papërfunduara.

Mësimi po fillon. Hapat janë të rëndë. Pikëllimi ta zërë frymën e fjalët është e pamundur të dalin nga goja. Sa e vështirë të nisesh për në klasën e tij, kur e di që ai nuk është, e të mendosh si t'i ngushëllosh shokët dhe shoqet e tij.

Leon, na e bëre shumë të rëndë fillimin e kësaj periudhe! Na e humbe vullnetin për punë! Na dëshpërove shumë! Por, ne do të jetojmë me kujtimin për ty! Do të kujtojmë buzëqeshjen tënde! Do të jesh përherë në mendjet dhe në zemrat tona!

PUSHO I QETË, ENGJËLL!

**Merita KUKAJ,**  
arsimtare e gjuhës shqipe



## PËR ZBULIMIN E VETES

*Koha kur një lodër na bënte të lumtur, e mund ta argëtonim veten pafund nuk krahasohej me asgjë. Imagjinata e asaj kohe (e fëmijërisë sime) ishte mahnitëse, sepse me një copë baltë mund të krijoja gjithçka të madhe. E po kishte momente, kur dëshira që të rritesha sa më parë ishte e madhe. Nuk e di se çfarë po mendoja atë kohë? Asgjë nuk më bënte të dyshoja se, në fakt, kush isha unë. Njeriu rrethohet nga gjithçka. Për ta zbuluar veten, duhet të veprosh me shpirt se çka dëshiron. Ku ndodhem? Ç'po bëj? Këto pyetje çdo ditë vërtiten rreth mendjes sonë. Duke dëgjuar zërin e brendshëm arrin ta zbulosh veten! Andaj, besoni në veten tuaj, sepse do t'i arrini qëllimet tuaja!*

**Elona BEQIRAJ, kl. IX/2**

## DITA E NËNËS

Tetë Marsi është Dita e nënës. Sa mirë që edhe nënat tona kanë ditën e tyre. E meritojnë ta kenë një ditë të tillë. Nënat tona janë më të mirat në botë. Ato na edukojnë që nga fëmijëria, prandaj respekti për to duhet të jetë në nivelin më të lartë. Sa herë që vjen 8 Marsi, unë përpiqem çdo herë ta gëzojë nënën time. I dhuroj lule të bukura dhe e përqafoj pafundësisht, duke e uruar e duke i dëshiruar jetë të gjatë e të lumtur pranë nesh. Nënë, të dua shumë! Uroj që festën tuaj ta festosh sa më gjatë e të jesh përherë e gëzuar!

**Lira SELIMAJ, kl. VII/2**

## PRINDËRIT E MI

*Në momenti që kam ardhur në jetë, ishte fytyra e nënës sime e duart e ngrohta të babait, që unë për herë të parë i kam ndjerë. Ju keni qenë çdoherë mbështetja ime më e madhe. Unë në këtë jetë kam ardhur, duke qarë, por që sot po buzëqesh falë jush. Dashuria më e madhe dhe e vërtetë është në mes të prindit dhe fëmijës, e cila asnjëherë nuk shuhet. Ajo është e lidhur me një zinxhir me hallkat më të forta, që asnjëherë nuk këputen.*

*Të gjithë prindërit në botë janë qenia më humane. Ata sakrifikojnë jetën për fëmijët e tyre. Prindërit janë bashkudhëtarët e rrugës sonë. Ne ecim në hapat e tyre. Duhet të jemi falënderuar tërë jetën për mundin, për edukimin e çdo gjë që ata na dhurojnë çdo ditë. Fëmijët janë bota për prindërit! E prindërit për ne fëmijët janë vetë jeta!*

**Engjëll SELIMAJ, kl. III/2**

## LUFTA GJATË VITEVE 1998-1999

*Lufta, së pari, filloi në Prekaz, ku u flijua për lirinë tonë komandanti legjendar, Adem Jashari, së bashku me familjen e tij.*

*Ai u lind më 28 nëntor të vitit 1955. Sa herë vjen 28 nëntori, ne i kujtojmë tri data historike: Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, daljen publike të UÇK-së dhe ditëlindjen e komandantit legjendar. Gjatë luftës së Kosovës, forcat serbe bënë masakra të mëdha, ku u dëbuan rreth 848000 shqiptarë, u vranë mbi 15000 njerëz, prej të cilëve 1500 ishin ushtarë të UÇK-së. Edhe fshati im, Greikoci përfetoi dhunë e tmerr gjatë luftës. Banorët u detyruan ta braktisin atdheun dhe të largoheshin për në shtetet fqinje. Fshati ynë martir ka edhe dëshmorë të kombit, siç janë: Jakup Kurtishaj, Hazir Selimaj, Avdyll Beqiraj, Haxhi Haxhaj, Zenel Curraj, Sabit Lushaj, Naser Tafaj, Safet Kicaj, Nuhi Tafaj dhe Fatmir Tafaj. Përveç këtyre heronjve, ne kemi edhe martirët e fshatit, të cilët u sakrifikuan për lirinë që ne sot po e gëzojmë.*

*Lavdi heronjve e martirëve të Kosovës nënë!*

**Rinesa SELIMAJ, kl. VII/2**

## ATDHEU IM

Atdheu është gjëja më e shtrenjtë në jetë. Ai është vendi, ku u linda e u rrita. Nuk ka gjë më të shtrenjtë se atdheu ynë – KOSOVA. Edhe po të vizitohet tërë botën, edhe po të jetoj me vite në ndonjë vend tjetër, prapëseprapë si atdheu ynë nuk ka. Shpirti ynë ka një ndjenjë të veçantë për vendlindjen tonë. Kosova është vendi më i ëmbël, që ka zënë vend në zemrat tona. Vendi ynë Kosova është e pasur me të gjitha të mirat e botës. Prandaj, të gjithë duhet të punojmë për ta zhvilluar sa më shumë. Atdheu ynë i dashur po vazhdon të ngritët lart e më lart. Duajeni atdheun dhe kurrë mos ia ktheni shpinën!

**Medina HAXHAJ, kl. VI/1**

## 17 SHKURTI

Kosova është atdheu ynë me mundësi dhe të drejta të barabarta për të gjithë. Që nga 17 Shkurti 2008, Kosova është e njohur si shtet nga shumë shtete të botës. Ne jemi duke shkuar drejt liberalizimit të vizave, që do të na mundësojë të udhëtojmë lirshëm në tërë botën, po ashtu edhe drejt BE-së. Kosova është atdheu ynë dhe duhet të na gëzojë fakti se më nuk jemi të robëruar dhe nën sundimin e askujt. Duhet të na gëzojë fakti se nuk e kemi lirinë e kufizuar si dikur dhe se nuk vuajmë si më parë. Populli shqiptar ka vuajtur shumë dhe ka kaluar shumë pengesa gjatë shekujve. Kosova u shpall shtet më 17 Shkurt 2008. Zemrat e të gjithë shqiptarëve u bënë mal nga gëzimi. Të gjithë me dashuri po ndërtojnë një të ardhme të ndritur për vendin e tyre, ku do të jetojnë të lirë dhe pa frikë. Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës cilësohet si një ditë tepër e veçantë dhe tejet e rëndësishme. Të parët tanë, për të na parë ne sa më të lumtur, sakrifikuam shumë. Ata dhanë edhe jetën e tyre. Prandaj, ne nuk duhet t'i harrojmë kurrë ata heronj dhe martirë, që dhanë jetën e tyre për lirinë që ne po e gëzojmë sot. Ata gjithmonë do të kujtohen me pietet e krenari. LAVDI HERONJVE E MARTIRËVE TANË!

**Ernesa LUSHAJ, kl. VII/1**

## FAMILJA LEGJENDARE JASHARI

Më 5, 6 dhe 7 mars 1998, familja Jashari sulmohet për herë të tretë nga forca të mëdha policore, ushtarake e paramilitare serbe. Serbia e kishte shumë seriozisht luftën me Jasharët legjendarë. Sulmi ndaj kësaj familjeje ishte bërë më qëllim që të goditej bërthama e UÇK-së. Serbia pësonte humbje gjithandej Kosovës, kurse hakmerrej ndaj popullatës civile. Sulmi në familje kishte qëllim zhdukjen e kësaj familjeje legjendare, por edhe futjen e frikës ndër shqiptarë në përgjithësi. Por, ndodhi e kundërta, shqiptarët u frymëzuan pikërisht nga heroizmi i familjes Jashari dhe shumë të rinj iu bashkuan Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lavdi për jetë e mot familjes legjendare Jashari!

**Aurela SELIMAJ, kl. IX/2**

## KULTURA

Kultura na nevojitet gjithmonë në jetën tonë të përditshme. Çdo kush duhet ta ketë kulturën, edukatën. Duhet t'i respektosh të tjerët, në mënyrë që edhe ti jesh e respektuar. Kultura e fisnikëron njeriun. Për mua një person i kulturuar është i edukuar, tolerant, inteligjent, i përgjegjshëm. Ai e respekton veten dhe ata që e rrethojnë. Një person i kulturuar nuk gënjen kurrë. Personat e kulturuar kanë qëllime të qarta, të cilat i arrijnë në jetë. Kultura tregon identitetin e një personi. Kultura nuk fitohet vetëm nga njerëz të tjerë, që janë të shkolluar, por edhe nga njerëz të tjerë që janë të pashkolluar, por që e marrin kulturën nga përvoja e jetës së tyre.

**Bertina CANAJ, kl. VI/1**

## SHOQËRIA

Shoqëri është lehtë thuash, por e vështirë për disa njerëz për t'u mbajtur. Të kesh një shoqëri të vërtetë do të thotë të kesh një gjë në jetë. Shoqëria të përkrahë në çdo hap të jetës. Fjala shoqëri është shumë e lehtë të thuhet, por shumë e vështirë të gjesh një shoqëri të vërtetë. Prandaj, mbajeni shoqërinë tuaj! Asnjëherë mos e lejoni që ajo shoqëri të shkatërrohet është ajo që të kupton në shumë gjëra. Dua që të gjithë të kemi një shoqëri, sepse me ta ndajmë të mirën e të keqen. Mos harroni se shoqëria e vërtetë ju gjendet gjithmonë pranë!

**Blerona KICAJ, kl. VI/1**

## SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 Shkurt të vitit 2008 në orën 15.39 minuta në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë.

Në një mbledhje të jashtëzakonshme, ku mermin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Ligjshmëria e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës për një kohë ka qenë temë e diskutueshme. Serbia duke kundërshtuar Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës kërkonte vlerësimin e vlefshmërisë ndërkombëtare dhe mbështetjen për pozicionin e saj, gjoja se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës është e paligjshme. Në vazhdim e kësaj ecurie, në tetor të vitit 2008, Serbia kërkoi një opinion këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, ishte kurorëzim i një rrugëtimi të gjatë e të vështirë për qytetarët e Kosovës.

**Armira TAJAJ, kl. VIII/2**

## LAJME TË SHKURTRA

•Drejtor i ri i shkollës sonë u zgjodh, z. Bestar Beqiraj.

•Duke u bazuar në mbledhjen e KDSH-së të mbajtur më 24.12. 2021 dhe pikës së 15-të të Rregullores së shkollës u vendos të formohet një komision për t'i pajisur nxënësit me uniforma. Komisioni përbëhej nga: Merita Kukaj, Ferat Beqiraj dhe Raza Spahiu. Komisioni ka kryer punën me përkushtim dhe nxënësit e shkollës sonë janë pajisur me uniforma. Vlen të potencohet se për një pjesë të nxënësve (raste sociale) pagesën për uniforma e bëri Shoqata "Greikoci". Për këtë kontribut të Shoqatës i jemi shumë falënderues.

•Vlen të theksohet se para disa kohësh u shpall tenderi për ndërtimin e një salle të edukatës fizike në kuadër të shkollës sonë. Ndërtimi i kësaj salle do të ishte me interes për nxënësit tanë, ngase e dimë rëndësinë që ka edukata fizike për nxënësit në përgjithësi.

•Shkolla jonë është fituese e një donacioni nga MASHT-i në vlerë prej 30.000 mijë eurosh. Në kuadër të këtij donacioni shkolla jonë u furnizua me: Mjete higjienike, makina për larjen e dyshemeve, për largimin e borës, vegla pune të ndryshme për shkollë, dezinfektues për zjarrfikës, shporta të ndryshme për mbeturina, kuti për ndihmë të parë, makina për kositjen e barit, makina për larjen e pllakave, etj.

•Biblioteka e shkollës sonë u pajis edhe me 500 tituj librash të rinj. Këta tituj të rinj do të shfrytëzohen ekskluzivisht nga nxënësit tanë.

•Për nder të Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008), arsimtarët e shkollës sonë në bashkëpunim me nxënësit tanë ka përgatitur një program të pasur kulturor e argëtues. Fjalën e rastit për nder të kësaj feste e mbajti mësuesja, Pranvera Selimi.

•Në shenjë nderimi dhe respekti për 7 Marsin – Ditën e Mësuesit u përgatit një program i begatë kulturor dhe argëtues. Fjalën e rastit për këtë datë të shënuar e mbajti mësuesi, Fikret Ramaj.

•Për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit shkolla jonë zgjodhi mësuesin më të mirë – Gani Kicaj.

•Komisioni për vlerësimin e brendshëm të shkollës në përbërje të të cilit ishin: Muhamet Kicaj, koordinatori i cilësisë, Fikret Ramaj, Sami Baraliu, Raza Spahiu, Hashim Kukaj dhe Besim Halitaj pas një pune një mujore arritën që t'i vlerësojnë dy fusha të cilësisë: Menaxhimin dhe qeverisjen dhe Mësimdhënien dhe të nxënit.

•Në kuadër të trajnimeve për kurrikulë, vlen të theksohet se mësuesit tanë: Fikret Ramaj dhe Sami Baraliu me sukses kanë kryer trajnimin 6 ditor për kurrikulë, si dhe kanë dorëzuar dosjen, e cila u vlerësua lart nga ligjëruesja e kurrikulës - Zana Saraqini.

•Më 26.12.2021 ( e shtunë) nxënëset e shkollës sonë: Fjolla Tafaj, Melisa Beqiraj, Lorieta Kicaj, Sumeja Kicaj, Ernesa Lushaj, Arijona Demaj morën pjesë në videoklipin e këngës "Cinema" interpretuar nga nxënësja jonë, e cila jeton dhe vepron në Gjermani, Elida Rrahmani. Duhet potencuar se gjatë gjithë xhirimeve që u bënë për videoklipin në fjalë, nxënëset tona treguan sjellje të shkëlqyeshme, përkushtim dhe mbi të gjitha nivel të lartë edukativ. Gjithashtu, edhe ekipet që morën pjesë gjatë xhirimeve i lavdëruan nxënëset tona për nivelin e lartë të treguar. Krejt në fund, këngëtares Elida Rrahmani, por edhe nxënëseve tona që e shoqëruan në videoklip suksese në punë e projekte të ardhshme.

Kronisti i shkollës

### MJEDISI DHE PROBLEMET MJEDISORE

Aktivitetet njerëzore, me veprime jo të duhura ndaj ambientit që na rrethon janë rezultat i ndryshimeve klimatike, d.m.th. ne kemi nxitur aktivitetin duke përsheptuar ndryshimet ambientale të vendit tonë posaçërisht qytetit. Por, përballja me të kërkon një angazhim global, dhe është e nevojshme të vihet në pah vetëdijesimi publik dhe në rend të parë të krijohen politika nëpërmjet të cilave kanë për qëllim informimin e opinionit për rreziqet, që po i kanoset qytetit tonë.

Mbrojtja dhe menaxhimi i mjedisit është një detyrë e rëndësishme e mbarë shoqërisë së një vendi në mënyrë shumëdimensionale. Të menaxhosh mjedisin do të thotë të sigurosh cilësinë e jetës së njerëzve, t'i trajtojë dhe t'i përdorë mirë resurset humane, të sigurosh zhvillim ekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm, t'i kontrollosh ndryshimet klimatike dhe pasojat që lidhen me të, të mbash parametrat dhe treguesit mjedisor të



të gjitha elementëve përbërëse në nivel standard të lejuar.

Si burim i problemeve është mungesa e ndërgjegjësimit të publikut në të gjitha aktivitetet dhe projektet e hartuara dhe të zbatuara.

- Mungesa e materialeve senzibilizuese në: postera, fletushka, spoteve në TV, materiale shkollore, ku trajtohen çështje dhe problematika mjedisore.
- Niveli i edukatës dhe kulturës mjedisore në shoqërinë tonë është ende i ulët dhe shqetësues.
- Informimi jo aktiv i publikut nga ana e medias për problemet mjedisore të qytetit.
- Moszbatimi ligjor etj.

#### Disa probleme me të cilat përballlet qyteti i Suharekës

- Hapësirat e gjelbëruara.
- Mungesa e ujit të pijshëm.
- Mungesa e parkingjeve.
- Mungesa e nevojtoveve publike.
- Ndërtimi pa planimetri.
- Humbja e sipërfaqeve bujqësore.
- Etj.



**Mr. sc. Besim Halitaj**

**Dëshmorët e Grekocit**

## **PROCESET JETËSORE - METABOLIZMI**

Metabolizmi është term i përbashkët i reaksioneve kimike, të cilat janë bazë e rritjes, e ngacmueshmërisë, e lëvizjes, e ndarjes dhe e riprodhimit të qelizës. Ato mund të ndahen në dy grupe reaksionesh, të cilat quhen katabolizëm dhe anabolizëm.

### **KATABOLIZMI**

Me katabolizëm nënkuptojmë të gjitha reaksionet kimike në qelizë, të cilat shpërbëjnë materiet e përbëra në ato të thjeshta dhe lirohet energjia (reaksionet e shpërbërjes). Gjatë procesit të katabolizmit gjithmonë lirohet energjia.

### **ANABOLIZMI**

Me anabolizëm nënkuptojmë të gjitha reaksionet kimike në qelizë gjatë të cilave krijohen materie të reja (reaksionet e sintezës). Anabolizmi gjithmonë kërkon energji, e cila duhet të sigurohet, sepse ato sasi të vogla, të cilat prodhohen gjatë kohës së reaksionit, nuk janë të mjaftueshme (d.m.th. rezultat i përgjithshëm i anabolizmit është "humbja" e energjisë). Energjia e duhur merret gjatë procesit të katabolizmit.

### **SHPEJTËSIA E METABOLIZMIT**

Te njeriu ndryshon shumë prej individit në individ, ndërsa në të njëjtin individ ndryshon varësisht prej kushteve të mjedisit. Shpejtësia e metabolizmit rritet gjatë stresit, kur temperatura e trupit rritet, si dhe gjatë kohës së ushtrimeve. Prandaj, koha më e përshtatshme e matjes së shpejtësisë së metabolizmit është kur individi pushon dhe kur ka temperaturë trupore normale. Kjo quhet shpejtësia bazale e metabolizmit dhe shprehet në kalori ose kiloxhula për metër katror të sipërfaqes trupore në orë.

Njerëzit që kanë shpejtësi të madhe bazale të metabolizmit mund të hanë sasi

të madhe të ushqimit dhe të mos e shtojnë peshën, sepse katabolizmi i materieve ushqyese (në qeliza) të tyre ndodh aq shpejt sa sasia e tepërt e yndyrës nuk grumbullohet si rezervë.

Njerëzit që kanë shpejtësi të ulët bazale të metabolizmit lehtë e shtojnë peshën. Në shpejtësinë e metabolizmit ndikojnë disa lloje hormonesh, veçmas tiroksina, adrenalina dhe noradrenalina.

### **ENERGJIA PËR JETËN**

Të gjitha qelizat paraqesin sisteme komplekse për transformimin e energjisë nga një formë në një tjetër, nëpërmjet reaksioneve të ndryshme kimike. Vetë esenca e jetës qëndron në krijimin e energjisë në brendësi të një qelize, në kalimin e saj nga një qelizë në tjetrën dhe nga një organizëm në një tjetër.

Tek qeniet e gjalla dallojmë tri forma të transformimit të energjisë:

1. Energjia e rrezeve të dritës në bimë të gjelbra nëpërmjet procesit të fotosintezës transformohet në energji kimike. Energjia e tillë shërben për sintezën e karbohidrateve e të molekulave të tjera komplekse.

2. Energjia kimike e karbohidrateve dhe e molekulave të tjera, transformohet nëpërmjet procesit të frymëmarrjes qelizore, në energji biologjikisht të përdorshme. Transformimi i tillë i energjisë ndodh në mitokondri.

3. Energjia biologjikisht e përdorshme (në formën e lidhjeve fosforike) përdoret nga qeliza për veprime mekanike, punë elektrike të transport-impulsit nervor, punë osmotike të lëvizjes së molekulave, punë kimike e sintezës së molekulave, ndarjes qelizore, etj. Veç kësaj në mjedis lirohet edhe energjia e lirë në formë të nxehtësisë.

**Gani KICAJ, arsimtar i biologjisë**



# KOPSHTI POETIK



## MËSUESIT TIM

I dashur mësues  
Sa shumë që të dua  
Sepse ti çdo ditë  
Diçka të re më mëson mua.

Mësime të mira  
Unë po mësoj  
Në të ardhmen time  
Do t'i praktikoj.

Lulet më të bukura  
Sot për ty i kam blerë  
Ne do të bëhemi të ditur  
Për ty është me vlerë.

Urime 7 Marsin  
Mësuesi im i parë  
Festofsh dhe shumë vite  
Në dorë me ditar!

Fjalët e tua të ëmbla  
Kurrë nuk do t'i harroj  
Gjithmonë e në çdo kohë  
Ato do t'i kujtoj.

Anuar **SELIMAJ** – I/1

## MËSUESI IM

Hyra në klasë të parë  
Asgjë s'kemi ditur  
Me dashurinë dhe mundin tënd  
Gjithmonë kemi arritur.

Je pikërisht ti mësues  
Ai që na edukon  
Je pikërisht ti që çdo  
Gjë na mëson.

Është puna e juaj e palodhur  
Që ne kemi respekt  
Është vullneti yt për  
Punën që ti ke në jetë.

Jam shumë e gëzuar  
Sepse di të lexoj  
Dhe me ndihmën tënde  
Shumë gjëra do të mësoj.

Advije **QELAJ** - I/2

## DITA E ALFABETIT

Vlerë e shquar e Kongresit  
Ditë e lumtur e Alfabetit  
Në Manastir zbardhi drita  
Gurakuqi e Gjergj Fishta.

Alfabeti u shfaq në nëntor  
Zbriti në Manastir si meteor  
Qytet i lashtë me kulturë  
Emir yt s'do të harrohet kurrë.

Dua të shkruaj kuq e zi  
Shkronjat unë që i di  
Si hëna e plotë e skuqur  
Alfabeti ynë i bukur.

Urata **TAFAJ** – V/1

## 7 MARS

Na erdhi 7 marsi  
O sa gëzim  
Me lule mbushi  
Gjithë vendin tim.

Fëmijët e vegjël  
Shumë të gëzuar  
Të gjithë vrapojnë  
Me buqeta në duar.

Të gjithë vrapojnë  
Kush e kush i parë  
Për t'i dhuruar lulet  
Mësueses sa më parë.

Artur **BEQIRAJ** - I/2

## TË DUA VËLLA

Të dua shumë vëlla  
Si ti vëlla nuk kam pa  
Ti je shumë i veçantë  
Për ty ndjehem shumë  
me fat.

Si ti nuk ka asnjë tjetër  
Për ty shkruaj këtë poezi  
Dije s'do të shkruaj përsëri  
Për ty vëlla, kam shumë  
dashuri.

Të ruajt zoti ty vëlla  
Të bekoftë perëndia  
Je më i miri në botë  
Për ty vëlla shkruaj sot.

Blin **KICAJ** - VII/2

## MËSUESJA IME

Kur hyra në klasën e parë  
Kisha shumë mendime  
Cilën mësuese do ta takoja  
Dhe të jetë brenda zemrës  
sime.

Mësuese e dashur  
Të falënderoj  
Sa do të jetë jeta  
Kurrë s'do të harroj.

Anjesa **TAFAJ** – V/2

## GJYSHI IM

Gjysh, oh gjysh  
Ti ku je  
Nipin tënd  
Pse e le?

Të thërras  
Më vjen të bërtas  
Mall i yt zemrën  
Do të ma plas.

Ti ike më le mall  
Po zemra ime  
Gjithmonë brenda  
Të mban gjallë.

Erdi **ZENELAJ** - IV/1

## NËNA

Moj e lumja nënë  
Që më bën dritë si hënë  
Ti që je gjithë këtu për  
mua  
Njeri i parë që i kam thënë  
të dua  
Ti që më fale veç buzëqeshje  
Ti që më fale veç gëzime  
Ti moj mburoja ime.

Melisa **BEQIRAJ** – VI/2

## NËNA

Moj e lumja nënë  
Që më bën dritë si hënë  
Ti që je gjithë këtu për mua  
Njeri i parë që i kam thënë  
të dua  
Ti që më fale veç buzëqeshje  
Ti që më fale veç gëzime  
Ti moj mburoja ime.

Melisa **BEQIRAJ** – VI/2

## ADEM JASHARI

Adem Jashari trim legjendar  
Dha jetën për ta çliruar  
popullin shqiptar  
Në Prekazin e shenjtë  
Luftoi e kurrë s'u tremb.

Me armikun ballë për ballë  
Mori armët hiç pa u ndalë  
Ademi me forcat e tij luftoi  
për liri  
E ne bacë Ademin kurrë  
s'do ta harrojmë  
Për liri do të festojmë.

Melisa **KURTISHAJ** - VII/2

## NËNA IME

E shtrenjta ime  
Sa shumë që të dua  
Sa herë ndihem keq  
Ti je gjithmonë aty për mua.

Artur **BEQIRAJ** - I/2

## LULET

Sa të ëmbla  
Sa të bukura  
Lulet janë  
Ambientin e zbukurojnë  
Anë e mbanë.

Unë për lulet kujdesem  
Me shumë kënaqësi  
Sepse ato më dhurojnë  
Aromë dhe freski.

Esma **HAXHAJ** – I/2

## 8 MARS

Kur shkoj në shtëpi  
E kërkoj nënën  
Me gjithë dashuri  
Ia uroj festën.

Kjo ditë është e tyre  
E festofshin me dashuri  
Urime gjithë nënave  
Lumturi e harmoni!

Nëna ime  
E shtrenjta ime  
Gëzuar 8 Marsin  
Mbretëresha ime!

Lejla **DEMAJ** – V/2

## GABIMI DHE FALJA

Gabimet janë të shumta  
Dhe të pavërteta  
Jemi ne ata që gabojmë por  
Jemi edhe ne që falim  
e mendojmë.

Njerëz jemi kemi shumë  
të drejta  
Gabimet nga ne shkaktohen  
Dhe faljet janë të vërteta  
Për njerëzit që kanë shpresa.

Urata **TAFAJ** – V/1



# KOPSHTI POETIK



## 17 SHKURTI

Sa kohë ka kaluar  
Derisa erdhi kjo ditë  
Sa shumë njerëz janë flijuar  
Sa shumë kemi prit.

Plot sakrifica e mundime  
Plot vuajtje e padrejtësi  
Kaloi kjo Kosova ime  
Gjatë rrugës për Pavarësi.

Vite e vite të tëra  
Trimat për liri luftuan  
Ditë e ditë të tëra  
Nënat lotuan.

Sa e shenjtë  
E sa e çmuar është kjo ditë  
Sa me mall thërrasim  
Kosova Republikë.

Ëndrra shekullore  
E shqiptarëve je ti  
Amaneti i atyre  
Që dhanë jetën për liri.

Verona **KURTISHAJ** - VIII/1

### SHKOLLA

Aty ku filluam  
Rrugëtimin e ditorisë  
Aty ku filluam se çfarë  
Do të bëhemi një ditë.

Për çdo arritje  
Që një ditë do të kem  
Përherë falënderuese  
Shkollës dhe mësueses  
do t'i jem.

Olti **SELIMAJ**  
- III/2

### KOSOVË

Kosovë, moj trimëreshë  
E djegur, e shkatërruar  
E përgjakur gjithmonë  
Por, asnjëherë e dorëzuar.

Bijtë e tu Kosovë  
Na e falën lirinë  
E fal tyre sot  
Festojmë Pavarësinë.

Ata falën jetën  
Për ty Kosovë u flijuan  
Ata vdiqën  
Përgjithmonë për të jetuar.

Mirlinda **KICAJ** - IX/1

### SHKOLLA IME

Dy gjëra më të shtrenjta  
Që unë i adhuroj  
Janë vendlindja ime  
Dhe shkolla ku mësoj.

Aty pranë shkollës  
Unë fitova dije dhe  
edukatë  
Vetëm shkollës sime  
I takon kjo lëvdatë.

Në shkollën e fshatit  
tim

Nxënës e fëmijë  
Nisin të mësojnë  
Të marrim ditori.

Flori **KICAJ** - III/2

### PRANVERA

U zgjova në mëngjes  
Diçka më gëzoj  
Era e luleve vinte  
E dielli prej shiut triumfoi.

Erdhi pranvera  
Zogjtë po cicërojnë  
Lulet filluan të dalin  
Që fëmijët t'i gëzojnë.

Dashurinë e pranverës  
Më shumë se kurrë po  
e ndjej  
Kur shoh diellin që lind  
E lulet me bukuri të blejnë.

Almir **TAFAJ** - III/2

### 7 MARS

7 Mars ti je legjendë e historisë  
Rruga e legjendarit drejt lirisë  
Me ty u ngritën shkolla  
Me ty u formuan dijet tona.

Nuk është luftë, por histori  
për arsim e ditori  
Të pamposhtur e të etur për ditori  
Hapëm çerdhe, kopshte, shkolla  
Që t'i edukojmë gjeneratat tona.

Mësuesi i dashur simbol i ditorisë  
Frymë e lirisë, paqes, demokracisë  
Në shumë breza ke një emër  
Çdo herë do të mbetesh në zemër.

Ti më dhe gjuhën e amësisë  
Më formove rrugën e ditorisë.

Eriola **BEQIRAJ** - VIII/1

### PAVARËSIA

Nëpër bjeshkë e nëpër male  
Luftuan trimat për lirinë  
Tash dhe t'i Kosovë e dashur  
Po feston Pavarësinë.

Nënë moj Kosovë  
Luftuan trimat që të çlirojnë  
Nga armiku serb e barbar  
Pavarësinë e gëzofshim mbarë!

Pavarësia - festa jonë  
E festojmë me admirim  
Gëzuar Kosovë  
Gëzuar o vendi im!

Njomza **TAFAJ**

### NËNA

Aromë lule, erë trëndafili  
Rrezatim dielli  
Sy magjepsëse, buzëqeshje mjalti  
Sy kaltërsie, por si oqeani!

Mbytem në sytë e tu  
Rritëm në prehrin tënd  
Dora jote e butë kur më ledhaton  
Çdo plagë timen disi e shëron!

Në prehrin tënd, sa i qetë qëndroj,  
Si në dorën e Zotit veten e mendoj  
Çdo këshillë e jotja, rrugën ma udhëzon  
Çdo mësim nga ty jetën më ndriçon.

Mrekulli e rrallë, mrekulli magjepsëse  
Bukuri e rrallë, shpirt luanëshë  
Urime 8 Marsin bukuri e rrallë  
Urime për ty, o mbretëresha NËNË!

Dorart **SHAHINAJ** - VI/1

### 7 MARS

Mësuesi im i dashur  
Sa shumë që të dua  
Shkrim e lexim  
M'i mësove mua.

Sot është festa jote  
7 Marsin ta uroj  
Me një lule të bukur  
Nga zemra të falënderoj!

Faleminderit shumë  
Për mundin e dhënë  
Për ditorinë e respektin  
Mua që ma ke falë!

Erdi **SHAHINAJ** - I/1

### PRANVERA

Pranvera ime  
Shumë më gëzon  
Gjithë natyrën  
Ajo zbukuron.

Pranvera ngrohu  
Në vendin tim  
Zogjtë shtegtarë  
Kthehen me nxitim.

Earta **NEZIRAJ** - I/2

### MËSUESJA

Mësuesja ime  
E dashur  
Sa fortë që të dua  
Ti je engjëll për mua.

Festën e mësueses  
Unë do t'ia uroj  
Ndër lulet më të bukura  
Unë do t'ia dhuroj.

Dijar **SELIMAJ** - V/2



# KOPSHTI POETIK



## LULES

Moj mimosë e bukur  
Mos çel për mua  
A s'më fal një tufë  
Nga lulet e tua.

Nesër unë në kopsht  
Do të shkoj me vrap  
Dhe mësuësues lulet  
Do t'ia jap.

Për 7 Marsin sot  
Na gëzojnë zemrat  
Se të duam fort  
Sa duam dhe nënat.

Mushak **LUSHAJ** - V/1

## VËLLAI

Nga do që shkoj  
Nga do që vij  
Mendja tek vëllai  
Më rri.

Pa ty dita  
Nuk më shkon  
Pa ty loja  
Nuk vazhdon.

Miliona yje natën  
E bëjnë dritë  
Vëllai është ylli  
Më i artë që shndrit.

Ari **ZENELAJ** - IV/1

## NËNA

Nëna ime e dashur  
Sa fortë që të dua  
Ti je zemra ime  
Ti je diell për mua.

S'ka në botë më të mirë  
Se sa ti o nëna ime  
E dashur gjithmonë  
Si hëna ndriçon.

Unë dashurinë për nënën  
Nuk di si ta shpreh  
Sepse e dua shumë  
Për nënën unë bëj lum!

Mua nënën time  
Askush s'mund ta zëvendësojë  
Sepse të gjithë mundin e saj  
Neve na e dhuroi.

Ti do të jesh e para gjithmonë  
Ti do të jesh e dashur për mua  
Ti do të jesh e vlefshme pafund  
Të dua nënë, oh sa shumë të dua!

Ema **KURTISHAJ** - V/2

## NËNA

Sapo hapi sytë e mi  
Nënën time shoh me sy  
Sapo zgjohem në mëngjes  
Nënën time e përshëndes.

E përshëndes e uroj  
Që më lindi e më edukoj  
Që në mëngjes jam duke menduar  
Për ty nënë dëshiroj të shkruaj.

Kur ia preki dorën nënës  
Sikur jam afër hënës  
Kur shikoj nënën me sy  
Gëzohemi krejt në shtëpi.

Leona **KURTISHAJ** - V/2

## PRINDËRIT E MI

Kur jam e trishtuar ata më ngushëllojnë  
Kur jam e sëmurë ata kujdesen për mua  
Kur sillem keq ata më disiplinojnë  
Sepse ata më duan e më çmojnë.

Kur kam nevojë për ndihmë ata më ndihmojnë  
Kur e humbas çdo besim  
Ata më ndihmojnë ta rimarr atë  
Kur kam nevojë për falje ata më falin  
Sepse ata më duan e më çmojnë.

Kur jam ftohtë ata më japin strehë  
Kur të humbas ata do të vinë dhe  
do të më gjejnë  
Pavarësisht se çfarë ndodh  
Unë e di se ata do të jenë gjithmonë atje  
Sepse ata më duan e më çmojnë.

Aurela **SELIMAJ** - IX/2

## 8 MARS

Në këtë mars të bukur  
Është dita e nënës  
Që ndriçon për mua  
Si rreze e hënës.

Nëna është person  
I veçantë për çdo njeri  
Kur dëgjoj zërin e saj  
Më mbushën sytë me lot.

Kur është afër meje  
Më merr malli shumë  
Ditën nuk jam e qetë  
Dhe natën nuk fle gjumë.

Duart e saj të buta  
Kur më ledhatojnë  
E nëse jam mërzitur  
Mërzinë ma largojnë.

Që ditën kur linda  
Mendoja për nënën time  
Se si më rriti mua  
E më përgatiti për mësim.

Elena **QELAJ** - VII/1

## MËSUËSJA

Ku të gjej fjalë  
Të shkruaj për ty  
Vallë a ka vargje  
Që të tregoj ty.

Kur më thua të lumtë  
Mua më zbukurohet dita  
Mësuesja ime e dashur  
Ke shumë merita.

Të kemi thënë  
Që je mbretëreshë  
Yll e hënë e rreze dielli  
Për ne je mësuese engjëll  
i zbritur nga qielli.

Alina **RAMADANI** - IV/2

## PRANVERA

Moj pranverë  
Moj stinë e bukur  
Kur qielli kthjellët  
Dielli rrezet i lëshon.

Malet i gjelbëron  
Fushat i lulëzon  
Bilbili këndon  
Fëmijët i gëzon.

Herët në agim  
Frynë erë e lehtë  
Kjo stinë e bukur  
Na mbush plot jetë.

Festina **BEQIRAJ** - IV/2

## MËSUËSJA IME

Mësuesja ime sa shumë  
Të dua ti je dielli  
I parajsës, ti je prind  
I dytë për mua.

Do të të mbaj gjithmonë  
Në mendjen time  
Në zemër, ngase ti ishe shtylla  
Jonë e diturisë.

Mësova të recitoj të këndoj  
Ti gjithmonë do të mbetesh  
Mësuesja ime e parë.

Samuela **KURTISHAJ** - V/2

## NËNA

Së pari herë  
Kur shkronjat mësova  
Fjalën nënë shqiptova.

Për herë të parë  
Kur u rrëzova  
Aty gjurin e lëndova  
Nënën fort e përqafova.

Fjala nënë jep dritë kudo  
E lut zotin fëmijët m'i mbro  
E unë sot për këtë ditë  
E uroj nënën me shpirt!

Blenera **KURTISHAJ** - V/2

## DËSHMORËT

Ku janë këta dëshmorë  
Që luftuan në shi e borë  
Me pushtuesin në të  
katër anë  
E këtë tokë me gjak  
e lanë.

Ata ishin zemërluan  
Ata ishin trimat tanë  
Janë heronjtë e kombit tonë  
Që me nder do t'i kujtojmë.

Denisa **CANAJ** - IX/2





# KOPSHTI POETIK



## DRITË O SHKOLLA IME

O dritë e syve të mi  
O frymë e shpirtit tim  
Je o shkolla ime  
Ti na jep gëzim.  
Gjigante e vërtetë  
Sa madhështore që je  
Në gjirin tënd të ngrohtë  
Për çdo fëmijë vend ke.

Një ditë do të rritem  
Por nuk di ka të shkoj  
Të vetmen gjë që di  
Ty kurrë s'do të harroj.

Bleron **KURTISHAJ** - IV/1

## TË RËNËVE PËR LIRINË E KOSOVËS

Tokë e përgjakur  
Në kohë të historisë  
Vriten pa mëshirë  
Shpirtrat e lirisë.

Nga shpirtrat e të rënëve  
Dëgjohej një zë  
O ju njerëz të gjallë  
Ruajeni dinjitetin tuaj  
gjithmonë!

Histori e përgjakur  
Nga shpirtra të vvarë  
Lule të venitura  
Të Kosovës nënë.

Yllza **KICAJ** – VI/1

## SHKOLLA

Shkolla ime e dashur  
Shkolla ime krenare  
Krenaria ime për ty  
Është sa lumturia.

Ne vijmë në shkollë  
Për t'u edukuar  
E për të mësuar  
Të jem e veçantë.

Aulona **KURTISHAJ** – III/1



**Nr. 15 - prill, 2022**

## NËNA

Nënë me vrap unë e përqafova  
Dhe një lule ia dhurova  
Nënë time shumë e dua  
Porsi dielli shkëlqen për mua.

Një lule nënës unë do t'ia dhuroj  
Dhe nga zemra të uroj  
Nënë time shumë e dua  
Sepse ajo është kujdesur gjithnjë  
për mua  
Dhe tërë jetën do ta dua  
Sepse është gjithçka për mua.

Lorent **CURRAJ** - IV/1

## PASTËRTIA

Është një gjë që të pastron  
Si luledritë pluhur të lëshon  
Pastërtia pluhur të bardhë  
Të lëshon po më pluhurin  
E bardhë shtëpinë ta pastron  
Luledritë ta bën.

Arigona **TAFAJ** - III/1

## NJË QERSHORI

Një qershori festa jonë  
Të gjithë fëmijët i gëzon  
Secili nga ta të kapur për dore  
E bëjnë festën ma madhështore.

Teuta **CANAJ** - III/1

## LIBRI

Libri na mëson  
Libri na lexon  
E shumë gjëra  
Tjera na i përkujton.

Tek ti kam mësuar  
Të lexoj e të numëroj  
Unë ty të dua  
Libri im i veçantë.

Libri që mësoj  
Libri që lexoj  
Libri që shkruajmë  
E shumë gjëra që i bëjmë.

Uron **TAFAJ** – III/1

## ATDHEU

Një vend i shenjtë  
Me vuajtje të mëdha  
Me krisma të ashpra  
Ku armiku zuri vend në të.

Me të qarat e fëmijëve  
Që kalonin mbi re  
Vuajtjet e nënave për djemtë  
e tyre  
Që u flijuan për atdhe.

Deri kur drita zbardhi  
Ishim në errësirë  
Trimat tanë vdiqën  
Por tashmë pushojnë të lirë.

Erleta e Anita **KICAJ** – VIII/2

## NËNA IME

Nëna ime e dashur  
Shumë të dua unë  
Ti mua më linde  
Ti mua më rrite  
Të falënderoj pafundësisht  
Nëna ime e dashur  
Drita e shtëpisë!

Drita **CANAJ** – III/1

## MËSUESJA IME

Kur shkoj në shkollë  
Mësuesja më përqafo  
Dy duart e arta  
Gjithë shkronjat më mëson  
Më mësove shumë gjëra  
Që unë nuk i di  
Shkronjat e para i mësova  
nga ti

Ti më edukove  
Qysh në klasë të parë  
Mësuesja ime e dashur  
Do të të bëj krenar.

Ramadan **SELIMAJ** – III/2



**Dëshmorët e Grekocit**

## Pak njohuri mbi folklorin shqiptar

Gjatë aktivitetit të tij jetësor ai ka krijuar kulturën dhe artin, në këto krijime zënë vend: këngët, përrallat, legjendat e proverbat, këngët e kreshnikeve dhe gjëegjëzat muzika e valët e ndryshme të kjo pasuri njihet me emrin folklor në anglisht: folk-popull, lore-dije.

Pasuria folklorike ndahet në:

- Folklor letrar (poezia, përrallat, legjendat e gojëdhënat, anekdotat e fjalët e urta, gjëegjëzat.)
- Folklor muzikor (meloditë e këngëve të valleve, meloditë instrumentale).
- Folklor koreografik (valët popullore).
- Folklor dramatik (lojërat, argëtimet, shfaqjet popullore).

### Tiparet e folklorit

Individi, krijon jeton mëson dhe kryen aktivitetin e tij jetësor në një mjedis të caktuar. Kolektivi, përzgjedh prej individit krijimet me të veçanta të tij duke ruajtur ato që janë me të bukura por edhe ato që i pëlqejnë me shume. Karakteri anonim, paraqitet pa emrin e individit të pare krijues. Kjo karakteristike është si rrjedhojë e transmetimit dhe e përpunimit brez pas brezi të krijimeve folklorike sipas shijeve dhe kërkesave të veta pa pyetur për të drejtat e autorit. Karakteri sinkretik ku një krijimi njëkohësisht e shoqëron me disa veprime. Karakteri popullore si krijimtari folklorike ai pasqyron me gjuhën e artit plot vibracion madhështi dhe saktësi jetën e popullit punën luftën dhe përpjekjet e tij gjatë shekujve.

### Vlerat e folklorit

Folklori u ka qëndruar shekujve, ndonëse, është transmetuar e ruajtur në kujtesën popullore brez pas brezi. Duke mësuar folklorin, ne mësojmë se si ka ecur dhe është zhvilluar, populli si i ka përjetuar fatet e veta historike, çfarë ka vlerësuar, etj.

Folklori ndryshe mund të quhet edhe gurra popullore.

### Folkloristika shqiptare

Folkloristika është një shkencë e cila merret me studimin e folklorit. Mbledhësi dhe studiuesi i folklorit quhet folklorist.

### Llojet e folklorit letrar

Me termin folklor letrar kuptojmë atë lloj folklori ku fjala është mjet kryesor komunikimi dhe krijimi artistik. Poezia popullore ndahet në tri gjini: lirike, epike dhe lirike - epike.

**Poezia popullore lirike:** Këto lloje i

klasifikojmë në tri grupe: poezi lirike familjare, poezi shoqërore dhe intime.

**Lirika familjare.** Ka të bëjë me çastet më të bukura të jetës se njeriut në familje, si dhe me çastet më të dhimbshme.

**Ninullat.** Janë krijime që nënat ua këndojnë fëmijëve të vegjël zakonisht kur i vënë në gjumë. Ato ndryshe quhen edhe këngë djepi ose nina-nana.

**Këngët e dasmës.** Dasma është një nga momentet kryesore në jetën njerëzore. Në këtë rit tradicional ku dy të rinj lidhin jetën e tyre zhvillohen ceremoni të ndryshme të cilat shoqërohen me këngë.

**Vajet.** Këto krijime kanë lindur gjatë vajtimin të të vdekurve. Humbja e njeriut të familjes kthehet në një tragjedi për ta, të cilët duan të nderojnë deri në fund, duke shprehur dhembjen që ju ka shkaktuar atyre.

**Lirika shoqërore.** Në lirikën shoqërore hyjnë ato krijime popullore që trajtojnë problemet shoqërore dhe shprehin mendime ndjenja dhe vlerësime për to. Disa nga llojet e lirikes shoqërore janë: këngët e kurbetit ose këngët e mërgimit ekonomik politik dhe ushtarak, këngët me motive shoqërore për natyrën këngët kundër padrejtësive.

**Këngët e kurbetit.** Në folklorin shqiptar ka një fond të pasur me këngët e kurbetit. Kjo shpjegohet me vendin e gjere që ka zënë kjo dukuri shkaqet janë të ndryshme ekonomik politike, etj. Drama që shpaloset në këngët e kurbetit ekonomik është e ndryshme diku vajtohet për ata që shkojnë nëpër botë pa dërguar as lajm as letër, diku shohim ata që kthehen rishtazi pasi tani nuk e kanë energjinë e dikurshme.

**Këngët e mërgimit politik.** Këto këngë i takojnë shekujve XV e XVI dhe lidhen drejtpërdrejt me emigrimin e shqiptarëve në grupe të mëdha në Italinë e Jugut, si rezultat i pushtimit osman. Në këto këngë zotëron dashuria për vendin e të parë dhe malli i madh.

Këngët e mërgimit ushtarak u kushtohen djemve të Shqipërisë, që merreshin nizame (ushtarë rekrut) në një periudhë shërbimi prej 7-12 vjetësh. Ata luftonin e vriteshin hapësirave e skajeve të Perandorisë Osmane. Në këto këngë ndjehet shumë dhembje.

**Ardhmërie BARALIU, prof. e kulturës muzikore**

## HOMOPHONES

Homophones are one of two or more words pronounced alike but different in meaning

Eye	I	meat	meet
Bare	bear	one	won
Be	bee	pair	pear
Brake	break	peace	piece
Cell	sell	plane	plain
Cent	scent	right	write
Dear	deer	sail	sale
Fair	fare	sea	see
For	four	site	sight
Hour	our	some	sum
Know	no	o	too
Made	maid	week	weak
mail	mail	wear	where

### A List of Contraction Forms

Are not = aren't  
Cannot = can't  
Could not- couldn't  
Di did not – didn't  
Do not – don't  
Does not – doesn't  
Had not- hadn't  
Have not- haven't  
He is- he's  
He has- he's  
He will- he'll  
He would- he'd  
He had- he'd  
Here is-here's  
I am- I'm  
I have- I've

is not = isn't  
it is = isn't  
it has- it's  
it will – it'll  
must not – mustn't  
she is – she's  
she has – she's  
she will- she'll  
she would – she'd  
she had- she'd  
should not- shouldn't  
that is-that's  
there is-there's  
they are- they're  
they have- they've  
they will- they'll

we are = we're  
we have= we've  
we will- we'll  
we would – we'd  
we had – we'd  
were not – weren't  
what is- what's  
where is- Where's  
who is- who's  
who will- who'll  
will not-won't  
would not- wouldn't  
you are- you're  
you have- you've  
you will- you'll  
you would-you'd

Haki **BEQIRAJ**, arsimtar i gjuhës angleze

## HISTORIKU I MOZAIKUT

Mozaiiku mund të përkufizohet si arti i zbukurimit të një sipërfaqeje, siç mund të jetë dyshemeja, muri ose një kub me figura që bëhen me copëza guri, xhami ose qeramike, të cilat ngjiten afër njëra-tjetrës. Mozaikët janë përdorur që në lashtësi për të zbukuruar dyshemetë dhe muret. Gjithashtu, mozaikët kanë zbukuruar pishinat dhe shatërvanët, vende ku lagështia do t'i kishte dëmtuar punimet artistike. Në të njëjtën periudhë në artin e trevave shqiptare, në truallin e Shqipërisë arriti zhvillimin më të madh edhe arti i mozaikut. Më i hershmi është gjetur në Durrës, i përket shekullit IV p.e.s dhe është i punuar me gurë zalli shumëngjyrësh. Ka vlera të rralla artistike që shquhen në gjithë krijimtarinë e kësaj gjinie. Quhet "Bukuroshja e Durrësit" dhe mund të cilësohet si bukuroshja e gjithë mozaikëve që janë zbuluar deri tani në truallin shqiptar, për hijeshinë e figurës dhe mjeshtërinë e realizimit artistik. Në shekullin I, siç përmendëm, u arrit lulëzimi i këtij arti dhe nga gurët e zallit u kalua në kubikë të prerë prej guri, qelqi, mermeri dhe baltë të pjekur. Mozaikë të tillë janë zbuluar në Apolloni, Durrah dhe Butrint.

Zhvillimi i mëvonshëm i mozaikëve lidhet, kryesisht, me monumentet paleokristiane. Pas shekullit V motivet e mozaikut ndryshojnë nga modelet e pikturave të hershme, siç është amazona mania në Apolloni, duke u zëvendësuar me figura simetrike që qëndrojnë të shkëputura në sipërfaqe dhe që paraqesin figura kafshësh, shpendësh, pemë frutore, lule dhe simbole të artit paleobizantin. Ruhen edhe sot në gjendje të mirë disa krijime të tilla, siç janë

Pagëzimet në Butrint, mozaikët e Linit dhe të Antigonës. Nga gërmimet e deritanishme, është gjetur vetëm një mozaik në Durrës, brenda Amfiteatrit të qytetit, që i përket shekujve VI-VII.

Shpesh mozaiku është quajtur art romak, për shkak të mozaikëve të shumtë që janë gjetur në Itali dhe në provincat e Perandorisë Romake. «Janë gjetur dyshe me të panumërta me mozaikë në ndërtesat e periudhës romake, duke filluar që nga Britania e Veriut e deri në Libi dhe që nga bregu i Atlantikut e deri në shkretëtirën e Sirisë.

Megjithatë, mozaikët shumëngjyrësh si piktura nuk i plotësonin nevojat e perandorisë së hershme. Rritja e madhe e qyteteve gjatë shekullit të parë të e. s. çoi në rritjen e kërkesës për mozaikë që bëheshin më shpejt dhe më me pak shpenzime. Kështu lindën mozaikët ku përdorshin vetëm copëza kubike bardhë e zi. Prodhimi u rrit ndjeshëm dhe sipas Enciklopedisë së artit të lashtë, «nuk gjeje asnjë shtëpi të pasur në ndonjë qytet të perandorisë që të mos kishte mozaik».

Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, artisti dhe historiani i artit, italian i Xhorxho Vazari shkruante: «Mozaiku është piktura më rezistente që ekziston. Pikturat e tjera veniten me kalimin e kohës, por mozaiku shkëlqen vazhdimisht ndër vite.» Po, mjeshtëria që pasqyrohet në shumë mozaikë na bën për vete. Mozaikët janë me të vërtetë piktura magjepsëse me gurë.

**Fahri KUKAJ, prof. i artit figurativ**

## GJUHË ANGLEZE

### DIFFERENCES BETWEEN BRITISH AND AMERICAN

#### American English:

Apartment  
College  
Vocation  
Schedule  
Airplane  
Mailbox  
Cookie  
Sweater  
Take a shofer  
Raise a child  
Have to  
Soccer  
Check

#### British English:

Flat  
University  
Holiday  
Time table  
Aeroplane  
Postbox  
Biscuit  
Jumper  
Have a shofer  
Bring up a child  
Have got to  
Football  
Bill

Përgatitën:

**Njomza Tafaj&Merlina Kicaj, kl. IX/1**

## Rëndësia e teknologjisë në mësimdhënie

Bota karakterizohet nga ndryshime të shumta dhe të shpejta, një pjesë e të cilave ka ardhur dhe nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Arsimi duhet t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjisë, dhe t'i përdorë ato gjerësisht në procesin mësimor. Këtyre ndryshimeve arsimi duhet t'u përgjigjet, me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente e të qëndrueshme të nxënësit, duke i reflektuar më pas këto në shoqëri për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë. Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i kësaj teknologjie gjatë procesit mësimor është bërë një domosdoshmëri për mësuesit. Ky zhvillim lidhet drejtpërsëdrejti me përditësimin e njohurive dhe të aftësive të reja në fushën e edukimit nga mësuesi. Teknologjia ka fuqinë dhe potencialin për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënies. Ajo ndikon mësimdhënien e suksesshme dhe u krijon mundësi mësuesve për të mësuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve e përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike.

Para shekullit të njëzet, tre mjetet kryesore të mësimit ishin mësuesi, teksti dhe tabela e zezë. Librat, letrat, lapsat ishin mjetet themelore për të hyrë në komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit. Shekulli i njëzetë, solli mbizotërimin e teknologjisë në arsim.

Shumë individë do të argumentojnë se kjo është ende e vërtetë sot, por nuk mund të mohohet ndikimi në rritje të teknologjisë në arsim. Roli i mësuesit si burimi kryesor i

informimit në klasë ka ndryshuar në të mësuarit organizativ, i cili çon nxënësit apo studentët për të kërkuar informacion të pavarur. Një tipar dallues i arsimit në të gjitha nivelet në vitet e fundit është përfshirja e teknologjisë në procesin e të mësuarit. Përdorimi i teknologjive të reja përbën një



nga ndryshimet më dramatike në arsim. Kombinimi i kompjuterëve dhe i përparësive të tjera teknologjike, si: videove me karakter didaktik, hiperteksteve e programeve të tjera përbën një aspekt reformues në fushën e arsimit. Në të gjitha vendet e botës janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të inkorporuar arritjet teknologjike në mjedisin shkollor dhe për t'i pajisur ato me infrastrukturë informatike. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit gjithnjë e më shumë në të gjitha aspektet e shoqërisë, bën të rëndësishëm futjen e TIK-ut si një lëndë me rëndësi të veçantë. Kjo bën të mundur që përdorimi produktiv dhe i besueshëm i TIK-ut të trajtohet si një mundësi thelbësore për jetën. Kjo lëndë përfshin jo vetëm mjeshtërinë e aftësive teknike, por edhe kuptueshmërinë për të zbatuar dhe aplikuar këto aftësi në jetën e përditshme, deri dhe në punësimin e nxënësve, menjëherë pas përfundimit të gjimnazit. TIK-u u krijon mundësi nxënësve të marrin pjesë dhe të angazhohen në shoqërinë bashkëkohore.

*Hashim KUKAJ, arsimtar i  
Teknologjisë*

# F J A L Ë K R Y Q I K L A S I K

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	
1																							
2																							
3																							
4																							
5																							
6																							
7																							
8																							
9																							
10																							
11																							
12																							
13																							
14																							

**HORIZONTALISHT:**

1. Themelues i Amerikës – një kontinent; 2. Punime toke – fekondim-aprovim; 3. Vend në Shqipëri – rrezja e madhe – emri i Baliqit – syprina – elektron; 4. Autoriteti qeveritar – jobarazim – futbollist i huaj; 5. Gjermania (simboli) – kampion – e bukura – kotem; 6. Që merret me art – kryeqendër shqiptare – bashkëtingëllore e 18-të – figura (shkurt); 7. Kantier – komandant i UÇK-së (nofka) – përemër vektor (huaj) – një zanore; 8. Një zanore – SIO – Tokë pune – emër femre – bashkëtingëllore – antiretroviral; 9. Nistorja e autorit të fjalëkryqit – një e shtata pjesë e tokës – Asociacion traduccion adaptacion autovizual de Espana; 10. Organ drejtues – punime me vlerë... – Muhamet Sejdiu; 11. Vështrim prapa – bashkëtingëllore e 18-të – Mbyll (huaj); 12. Intensiteti – Jo (huaj) – moti – identiteti (shkurt) – VSADU 13. Jo çift – emër (huaj) – zanore – zanore – emër mashkulli (rasa rrjedhore) – autoriteti qeveritar; 14. Banor i kontinentit të zi – terreni.

**VERITKALISHT:**

1. Veshje burrash – dukuri natyrore; 2. Emër mashkulli – republika demokratike – notë muzikore – EF; 3. Radio akustik ranging – verifikimi i forcës – KR; 4. XHTI – shteti ku po zhvillohen luftime – JR – intensitet; 5. I vogli i lopës – 100 (huaj) – lloj pije; 6. Testamenti – shteti ynë; 7. Shkronjë dyshe – emër mashkulli – reduktim potencial i oksidimit – ai (huaj); 8. Përemër pronor – KT – Artan (shkurt) – EK; 9. Ndërmarrja bujqësore (shkurt) – UE – mjeshtri – shënim (huaj); 10. Dominique Joseph ... – televizioni italian – përemër vektor – zanore; 11. Targa e Tiranës – Network... – emri i poetit të shquar (rasa kallëzore); 12. Aks (huaj) – shkoi – SERVA – Faradi; 13. Emër (huaj) – lloj sporti – notë muzikore; 14. Rezistues – erdhi – shkurtesa e Universitetit Islamik në Gaza; 15. Notë muzikore – new music in Sweden – lloj druri; 16. Që lidhet me kushtetutën – metal i çmuar; 17. Minimumi (shkurt) – R – I – përemër pronor – trajtë e shkurtër; 18. Ky (huaj) – bakër – Forcat e Armatosura të Kosovës – barsoletë; 19. Emër mashkulli – materiale të shkruara ose të shtypura për studimin e diçkaje; 20. Përemër vektor (huaj) – emri i djalit të Ali Pashës – notë

**E përpiloi: Tahir ZENELAJ**

# GALERIA E REVISTËS



Arssa Kicaj, kl.I/1




Aulona Kurtishaj, kl.III/1



Melisa Kurtishaj, kl.VII/1



Shkurtesa Zmajlaj, kl.VIII/1



Norela Lushaj, kl.VII/1



Ernesa Lushaj, kl.VII/1



Aulona Kurtishaj, kl.III/1

Paralelja parashkollore së bashku me edukatoren, Lumturie Kuçi





**BOTIMIN E KËTIJ NUMRI E SPONSORIZOI SHOQATA "GREIKOCI"  
ME SELI NË OSSINGEN - ZVICËR**